



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 156 Akti

Nr. 175 Vendimi
Tiranë, më 4.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------|
| Xhensila Pine | Kryesuese |
| Suela Zhegu | Relatore |
| Olsi Komici | Anëtar |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Maria Tuma, në Tiranë, më datë 3 korrik 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Valbona R. Seknaj (Durraj)**, me funksion gjyqtare/kryetare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj, me funksion gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.1.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.1.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Maria Tuma.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i KLD-së. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar².

¹ Raporti me shkresën me nr. *** prot., datë 8.2.2018, nga ILDKPKI-ja.

² Raporti me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 nga DSIK.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 14.6.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durraj), si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, znj. Valbona Seknaj (Durraj), i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe përfundimin kryesisht të hetimit administrativ në datën 19 qershor 2019, duke i kaluar barrën e provës. Për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit iu dha 9 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe të paraqes prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet paraprake të hetimit deri në datën 28 qershor 2019.

Znj. Valbona Seknaj (Durraj) u njoh me rezultatet e hetimit dhe ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 28.6.2019. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 3.7.2019, ora 10:00, në adresën: Pallati i Koncerteve, salla B, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Znj. Valbona Seknaj parashitroi përpara trupit gjykues kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ dhe për përfshirjen në procesin e rivlerësimit të dy kriterëve të tjera të vlerësimit, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional, si dhe kërkoi të administrohen me cilësinë e provës dokumentet origjinale të paraqitura prej saj në këtë seancë. Trupi gjykues u tërhoq për të shqyrtuar kërkesat e paraqitura nga subjekti dhe pasi i shqyrtoi ato në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi: i) të mos pranojë kërkesën e subjektit për riçeljen e hetimit; ii) të mos pranojë kërkesën për të përfshirë në procesin e rivlerësimit dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale; iii) të pranojë kërkesën për administrimin e dokumentacionit

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.7.2018, KLD-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 84/2016

të paraqitur nga znj. Valbona Seknaj në seancë dëgjimore. Në përfundim të kësaj seance, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj), ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjithë rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezultojnë se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar - Vetting dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) deklaratimet/provat shkresore të subjektit të rivlerësimit, me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Komisioni ka evidentuar faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar deklaratën e pasurisë “Vetting” në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive, duke e vlerësuar ato si: pasaktësi në plotësimin e “Deklaratës së pasurisë, së rivlerësimit kalimtar, Vetting”.

Arsyetim ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka shkëlur detyrimin kushtetues dhe ligjor, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit D të Kushtetutës; ai duhet të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, si dhe bazuar në pikën 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën, të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti ka deklaruar këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

1. Apartament banimi⁴, me sip. 115.3 m², në adresën Rr. “***”, shk. 1, k. 2, ap. 2, Tiranë.

Vlera e deklaruar: 78.000 euro.

Pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Burimi i krijimit: Subjekti në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

Mënyra e fitimit: Subjekti është shprehur se ky aset është blerë sipas kontratës së sipërmarrjes në datën 8.12.2004, finalizuar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2013.

1.1 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

ZVRPP-ja Tiranë⁵ konfirmon pasurinë, apartament me sip. 115.03 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve E. dhe Valbona Seknaj (bashkëlidhur kontratë shitjeje nr. ***, datë 15.11.2013).

OSHEE-ja⁶ informon se referuar të dhënave të sistemit të faturimit me emrin E.S. identifikohet një abonent me nr. kontrate ***, në Rr. “***”, në instancën e Tiranës, me datë hapje 8.10.2004. Emri ka ndryshuar nga T. M. në E.S. në datën 13.3.2015.

1.2 Analiza e provave

Në lidhje me këtë pasuri, duke analizuar dokumentacionin e administruar në dosje ka rezultuar se, në datën 8.12.2004, ndërmjet palëve kontraktore znj. Valbona Seknaj dhe sipërmarrësit/investitor z. T.M. është lidhur një kontratë sipërmarrje për ndërtimin/shitjen e apartamentit me sipërfaqe 130 m². Në kontratën e sipërmarrjes është parashikuar se investitori do të shesë të porositësi një apartament me çmimin 78.000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) euro.

⁴ Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacionin: certifikatë për vërtetimin pronësie nr. ***, datë 6.12.2013, për apartament me sip. 115.03 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi Valbona dhe E. Seknaj; kartelën e pasurisë së apartamentit me sip. 115.03 m², në bashkëpronësi Valbona dhe E. Seknaj; kontratë sipërmarrje datë 8.12.2004, me palë sipërmarrëse/investitore T.M. dhe palë porositëse Valbona Seknaj, për porositjen e apartamentit me sip. ndërtimi 130.33 m², sip. shfrytëzimi 99.52 m², me çmim 78.000 euro ku këstet do të paguhesh në këtë mënyrë: kësti parë 45.000 euro (nga të cilat 5.000 Euro janë kapar) do të paguhesh me nënshkrimin e kësaj kontrate, kësti i dytë prej 30.000 euro do të paguhesh në datën 5.2.2005, me dorëzimin e çelësave të apartamentit; dhe kësti i tretë prej 3.000 euro do të paguhesh në momentin e marrjes së hipotekës; kontratë shitje nr. ***, datë 15.11.2013, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., investitor T.M. dhe palë blerëse Valbona dhe R. Seknaj për blerjen e apartamentit me sip. ndërtimi 130.33 m², sip. shfrytëzimi 99.52 m², në vlerën 78.000 euro e cila është likuiduar totalisht përpara regjistrimit të këtij apartamenti në ZVRPP-në Tiranë.

⁵ Shikoni në dosje për më tepër shkresën nr. nr. *** prot., datë 21.11.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2019.

Në nenin B “*detyrimet e palëve*” të kontratës është parashikuar: “*Porositësi mbi bazën e kësaj kontrate pranon apartamentin e porositur dhe paguan çmimin sipas kushteve të kësaj kontrate në favor të shitësit dhe pagesa do bëhet në tre këste.*”

Kësti i parë i barabartë me 45.000 euro. Ky këst do paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate. Kësti i dytë 30.000 euro, do të paguhet në datën 5.2.2005, me dorëzimin e çelësve të apartamentit.

Kësti i tretë prej 3.000 euro do paguhet në momentin e marrjes së hipotekës”.

Në datën 15.11.2013, ndërmjet shitësve/investitorit sipërmarrës dhe palës blerëse, nënshkruhet kontrata e shitjes me nr. ***, për pasurinë apartament. Në kontratë është parashikuar se çmimi i shitjes së apartamentit është 78.000 euro dhe blerësit e kanë likuiduar totalisht çmimin e shitjes prej 78.000 euro, përpara regjistrimit të tij në ZVRPP-në Tiranë dhe jashtë kësaj zyre noteriale.

Në dokumentacionin e administruar nga dosja e ILDKPKI-së nuk disponohet dokument tjetër në lidhje me pagesën për apartamentin. Komisioni vlerëson se pagesat janë kryer sipas parashikimeve të kontratës.

1.3 Në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri në deklaratimet periodike vjetore.

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti ka deklaruar të shlyer shumën 45.000 euro, si dhe një huamarrje nga vëllai në shumën 10.000 euro (për të paguar këstin e dytë në shumën 15.000 euro).
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 ka deklaruar të shlyer detyrimin për banesën e blerë në shumën 15.000 euro (huamarrja nga vëllai 10.000 euro vazhdon të deklarohet e pashlyer).
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 ka deklaruar të shlyer detyrimin për banesën e blerë në shumën 9.000 euro (huamarrja nga i vëllai në shumën 10.000 euro vazhdon të deklarohet e pashlyer).
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti ka deklaruar të shlyer detyrimin për banesën e blerë në shumën 9.000 euro (huamarrja nga i vëllai në shumën 10.000 euro vazhdon të deklarohet e pashlyer/mbartur që nga viti 2004).
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 subjekti ka deklaruar të shlyer detyrimin e huamarrjes nga vëllai në shumën 5.000 euro, si dhe shumën 5.000 euro detyrim i mbetur për t’u paguar të vëllait.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti ka deklaruar se mbetet i papaguar detyrimi i të vëllait në shumën 5.000 euro, ndërkohë ka blerje automjeti në shumën 1.200.000 lekë.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti ka shlyer detyrimin e huamarrjes nga vëllai në shumën prej 5.000 euro.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 subjekti ka deklaruar të likuiduar këstin e fundit për apartamentin e banimit me sip 130 m², në shumën 3.000 euro nga kontrata e sipërmarrjes e datës 8.12.2004.

Për sa më sipër, vërehet se ka mospërputhje, pasi sipas deklaratimeve periodike vjetore subjekti për këtë apartament duket se ka paguar 81.000 euro, sipas kontratës duhet të paguante 78.000 euro.

1.4 Në lidhje me burimin e krijimit

Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri as në deklaratën “Vetting”, dhe as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004.

Në përgjigje të pyetësorit⁷ subjekti ka shpjeguar se për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer si burim:

- i. të ardhurat e krijuara nga biznesi privat i saj dhe i bashkëshortit të akumuluar, e më pas nga paga e saj si gjyqtare;
- ii. të ardhurat nga shitja e një apartamenti me sip. 66 m², në Shkodër, me çmim shitjeje 4.500.000 lekë, ku çmimi i shitjes ka qenë i ndarë në dy këste: 3.500.000 janë likuiduar në momentin e hartimit të kontratës datë 5.11.2004, ndërsa kësti tjetër prej 1.000.000 lekësh është likuiduar në dhjetor të vitit 2005;
- iii. të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit të ndodhur në Rr. “***” Tiranë, në vlerën prej 19.200 euro, për periudhën 2.4.2006 – 2.4.2010;
- iv. hua e marrë nga vëllai i subjektit, z. E.D., në shumën 10.000 euro.

Komisioni analizoi burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, nga ku vërehet se:

Në lidhje me burimin në pikën “i”, subjekti ka deklaruar “*të ardhurat e krijuara nga biznesi privat i të dy bashkëshortëve të akumuluar ndër vite e më pas nga paga e saj si gjyqtare*”, Komisioni ka vërejtur se subjekti, në përgjigjet e pyetësorit, nuk ka saktësuar shumat e kursyera, të cilat ishin përdorur si burim për blerjen e apartamentit.

1.5 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2004 – 2010⁸, për të vlerësuar burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë.

Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit, duke u mbështetur në dokumentacion ligjor zyrtar të lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe gjendjet apo lëvizjet në llogaritë bankare.

a. Të ardhurat nga paga e subjektit

Për periudhën 2004 – 2010 të ardhurat nga pagat janë në shumën 7.566.184 lekë.

b. Të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit

Referuar vërtetimit lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër⁹ jepet informacion për fitimin *neto* të realizuar nga aktiviteti privat i personit fizik “***” për periudhën 2008 – 2016, ndërkaq nuk jepet informacion në lidhje me fitimin *neto* të realizuar për periudhën 2004 – 2007. Për periudhën 1994 – 2007, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka vërtetuar vetëm pagesat e detyrimit tatimor ndër vite, si dhe ka listuar bazën ligjore mbi të cilën janë përlllogaritur këto shuma të paguara.

Qarkullimi, si dhe fitimi *neto* nga aktiviteti i bashkëshortit, tregohet në tabelën vijuese:

Tabela nr. 1

| Periudha tatimore | Detyrim i paguar sipas vërtetimit të DRT-së Shkodër | Pagesa sipas ligjit për sektorin | Qarkullimi | Marzhi i fitimit ¹⁰ | Fitim <i>neto</i> i përlllogaritur |
|-------------------|---|----------------------------------|------------|--------------------------------|------------------------------------|
| 2004 | 107 760 | 4% | 2 694 000 | 15% | 296 340 |
| 2005 | 96 300 | 4% | 2 407 500 | 15% | 264 825 |
| 2006 | 65 370 | 4% | 1 634 250 | 15% | 179 768 |

⁷ Shihni pyetësorin e dërguar datë 2.4.2019.

⁸ Periudha kur janë kryer pagesat për blerjen e apartamentit.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2019.

¹⁰ *Marzhi* i fitimit për aktivitetin është përlllogaritur si mesatare e fitimit të përlllogaritur nga vitet për të cilat ka të dhëna zyrtare për aktivitetin e E.S., nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për sa i përket qarkullimit dhe fitimit *neto*.

| | | | | | |
|--------------|-------------------------------|----|-----------|-----|------------------|
| 2007 | Nuk ka të dhëna ¹¹ | 4% | 4 100 000 | 15% | 451 000 |
| Total | | | | | 1 191 933 |

Të ardhurat e ligjshme nga aktiviteti i bashkëshortit, për periudhën 2004 – 2007 janë në shumën 1.191.933 lekë (shihni tabelën 2).

Sipas shkresës së ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, vihet re se shumat e të ardhurave *neto* nga aktiviteti privat i E.S., nuk përputhen me shumat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, as në deklaratën “Vetting”, dhe as në përgjigjet e pyetësorit të dërguara Komisionit. Në analizën financiare është marrë në konsideratë fitimi *neto* për të cilin është paguar detyrimi tatimor, bazuar në të dhënat e marra nga Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër.

Të ardhurat e ligjshme nga aktiviteti i bashkëshortit, për periudhën 2008 – 2010, janë në shumën **2.052.516 lekë**.

Tabela nr. 2

| Përshkrimi | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Total |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------------|
| Të ardhura nga aktiviteti i b/short në deklaratën “Vetting” 2004 – 2010 | 1 200 000 | 1 200 000 | 1 300 000 | 1 200 000 | 1 000 000 | 1 200 000 | 1 000 000 | 8 100 000 |
| Të ardhura, bazuar në pagesat e tatimeve sipas vërtetimit të DRT-së Shkodër, për periudhën 2004 – 2007 | 296 340 | 264 825 | 179 768 | 451 000 | - | - | - | 1 191 933 |
| Të ardhura <i>neto</i> sipas vërtetimit të DRT-së Shkodër, për periudhën 2008 – 2010 | - | - | - | - | 765 000 | 747 000 | 540 516 | 2 052 516 |

Të ardhurat e bashkëshortit, të deklaruara sipas deklarimeve periodike vjetore për periudhën 2004 – 2010, janë në shumën 8.100.000 lekë (shihni tabelën nr. 2). Të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit, për të cilat është paguar tatim për periudhën 2004 – 2010, janë në shumën 3.244.448 lekë, shumë e cila është reflektuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, si burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

➤ **Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e mbështetura në dokumentacion ligjor, krahasuar me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë të jenë në vlera më të ulëta, për këtë arsye subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën.**

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk provoi burimin e ligjshëm për të ardhurat e deklaruara për periudhën 2004 – 2010.

¹¹ Në periudhën 2007 – 2009, subjekti tregtar, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar qarkullim, pranë Bashkisë Shkodër në bazë të legjislacionit të asaj periudhe, dhe të dhënat mbi qarkullimin janë vërtetuar nga Bashkia Shkodër.

Në lidhje me burimin në pikën “ii”, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Shkodër, në shumën 4.500.000 lekë.

Komisioni, duke analizuar dokumentacionin e administruar në dosjen hetimore, ka vërejtur se: në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi një “kontratë për shitblerje pasurie të paluajtshme me këste”, për pasurinë apartament banimi me sip 66 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, nr. ***, në datën 5.11.2004, redaktuar pranë noteres E.A., me palë shitëse Valbona Seknaj dhe palë blerëse L.D. Sipas kësaj kontrate është likuiduar nga blerësi kësti I-rë në shumën 3.500.000 lekë, në momentin e nënshkrimit të saj, ndërsa kësti i II-të prej 1.000.000 lekësh do të likuidohet deri në datën 30 gusht 2005.

Pra, subjekti sipas deklaramit të tij, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ka disponuar vetëm shumën prej 3.500.000 lekësh (për të kryer pagesën e këstit të parë në datën 8.12.2004, për apartamentin e ndodhur në Rr. “***”, Tiranë).

Nga administrimi i dokumenteve të depozituara në ZVRPP-në Shkodër¹² për këtë pasuri, rezultoi një kontratë shitblerje “pasuri e paluajtshme” me nr. ***, datë 19.12.2005, hartuar te noter A.K., për apartamentin e banimit me sip. 66 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, me palë shitëse Valbona Durraj dhe palë blerëse L.D. Çmimi i shitjes së pasurisë është në shumën 2.000.000 lekë. Kjo kontratë është regjistruar në ZVRPP-në Shkodër në datën 30.12.2005.

Për sa më sipër, për apartamentin e shitur rezultojnë dy kontrata shitblerjeje, të ndryshme nga njëra-tjetra, hartuar nga noterë të ndryshëm dhe ku çmimi i shitjes ndryshon.

1.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime për arsyen e disponimit të dy kontratave të shitblerjes, si dhe të dokumentojë se sa ka paguar realisht blerësi.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit,¹³ ka shpjeguar se: “*Ekzistenca e dy kontratave për të njëjtën banesë me të njëjtat palë është pasojë e pagimit të çmimit të shitjes me këste. Kontrata me nr. ***, datë 5.11.2004, e përpiluar nga notere E. A., për shitjen e apartamentit të banimit me sip. 66 m², është kontratë shitje me këste. Çmimi i shitjes në total është 4.500.000 lekë. Po sipas kontratës, kësti i parë prej 3.500.000 lekësh është likuiduar në datën 5.11.2004. kësti i dytë prej 1.000.000 lekësh, do të likuidohet deri në datën 30.8.2005. Në kontratë është shënuar që: me likuidimin e këstit të fundit, blerësit i lind e drejta ta regjistrojë aktin e shitblerjes në emër dhe për llogari të tij në ZVRPP-në Shkodër ... Blerësja L.D. ka mundësuar pagimin e këstit të dytë brenda vitit 2005 dhe për finalizimin e dokumentacionit me përmbylljen e detyrimit prej 1.000.000 lekësh (këstit të dytë) është hartuar kontrata me nr. ***, datë 19.12.2005, tek noter A.K.*

Subjekti ka deklaruar ndër të tjera: “*Çmimi i vënë në kontratë 2.000.000 lekë nuk është i saktë, pasi ai duhet të ishte 1.000.000 lekë, aq sa ishte dhe kësti i dytë që blerësja më detyrohej. Kontrata e hartuar nga noteri A.K. duhej të mbante çmimin 1.000.000 lekë dhe jo 2.000.000 lekë. Subjekti ka deklaruar se ka firmosur në mirëbesim duke ditur që është për të njëjtën banesë e njëjta blerëse, e duke mbajtur në mendje që është për këstin e dytë. Nuk e ka memorizuar se sa është shënuar çmimi i shitjes (kësti i dytë), por e ka firmosur atë pa hezitim. Pasaktësia e çmimit të vënë është një gabim material, ndoshta veprim “copy paste” i noterit, i mbartur nga kontrata të ngjashme që noteri harton dhe i pa konstatuar nga subjekti në momentin e nënshkrimit. Kontrata e dytë nuk ishte gjë tjetër veçse veprim juridik për të*

¹² Shikoni shkresën me nr. *** prot., datë 19.12.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Shkodër.

¹³ Pyetësor i datës 7.5.2019.

formalizuar të gjithë detyrimin e përmbyllur prej 4.500.000 lekësh, të cilin kishte deklaruar në ILDKPKI që në momentin e parë të hartimit të kontratës datë 5.11.2004”.

Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të lëshuar nga blerësja L.D., në datën 11.5.2019, e cila deklaron se për blerjen e apartamentit ka paguar shumën 4.500.000 lekë, të ndarë me dy këste.

Në lidhje me burimin në pikën “ii”, Komisioni, duke analizuar dokumentacionin e administruar në dosje, ka konstatuar faktin se subjekti ka nënshkruar dy kontrata noteriale shitblerjeje për të njëjtën pasuri, me çmim tëndryshëm, ku akti i parë me çmimin e shitjes në shumën 4.5 milionë lekë është depozituar në ILDKPKI dhe akti i dytë me çmim më të ulët 2 milionë lekë është depozituar në ZVRPP-në Shkodër.

- **Komisioni, pas hetimi të kryer, vlerësoi si fiktive kontratat e shitblerjes me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji.**

Referuar pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet: “Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”, Komisioni, në analizën financiare, ka konsideruar si burim të ligjshëm çmimin e shitjes sipas kontratës noteriale të shitblerjes të depozituar në ZVRPP, si akt i përdorur për kalimin e pronësisë.

1.7 Në lidhje me burimin në pikën “iii”, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë, në vlerën 19.200 euro, për periudhën 2006 – 2010. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë qiraje nr. ***, datë 11.3.2006, me afat nga 2.4.2006 – 2.4.2010, dhe me pagesë mujore 400 euro. Në kontratë nuk është parashikuar se si do të paguhej tatimi në burim për të ardhurat e realizuara nga qiradhënia.

Subjekti, në lidhje me këto të ardhura, nuk i ka paguar detyrimet tatimore gjatë kohës që i ka përfituar të ardhurat, por i ka paguar detyrimet përkatëse në datën 4.12.2018, në shumën 1.920 euro.

- **Komisioni vlerëson se shlyerja e këtij detyrimi tatimor është kryer për efekt të rivlerësimit, për faktin se detyrimi është shlyer pas tetë vjetësh vonesë nga përfundimi i afatit të kontratës së qirasë.**

Komisioni vlerësoi se pagesa e këtij detyrimi është kryer për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit, pasi ai është deklaruar dhe paguar pranë institucionin tatimor tetë vjet pas përfundimit të efekteve ligjore të kontratës së qirasë. Trupi gjykues argumentoi se në përfundim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga qiradhënia, këto të ardhura janë përfshirë në analizën financiare, duke u konsideruar si burime të ligjshme.

1.8 Në lidhje me burimin e deklaruar në pikën “iv”, për huan në shumën 10.000 euro, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit¹⁴, deklaroi se këtë hua e ka marrë nga vëllai i saj, sipas deklaratës së huamarrjes me nr. *** rep., datë 4.2.2005, hartuar nga notere E.A. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk e ka depozituar këtë deklaratë noteriale në Komision. Subjekti ka deklaruar në pyetësor, por dhe në deklaratat periodike vjetore periodike, se huan e ka likuiduar në dy këste, një pjesë në shumën 5.000 euro në vitin 2008 dhe shumën 5.000 euro në vitin 2010. Këtë shumë e ka marrë për të bërë likuidimin e kështit të dytë të apartamentit në Tiranë të blerë me kontratën

¹⁴ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2019.

e sipërmarrjes datë 8.12.2004. Kësti i dytë është likuiduar në datën 5.2.2005 në shumën 15.000 euro, ku 10.000 euro ishin të marra hua nga vëllai.

Referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose personat të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

1.9 Në lidhje me mundësitë financiare të vëllait të subjektit, z. E.D., për dhënien e kësaj huaje, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë burimin e ligjshëm të krijimit.

Subjekti ka depozituar shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër¹⁵, sipas të cilës shtetasi E.D. me NIPT ***, është regjistruar si tatimpagues, person fizik, me aktivitetet: “*tregtim me pakicë e artikujve të imët, bojëra tulla qelq, etj*”. Ky tatimpagues nga data 3.12.2007, është trajtuar si biznes i madh, është ç’regjistruar në datën 30.6.2008 dhe është regjistruar si person juridik “***” sh.p.k.

Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti¹⁶, Komisioni vëren se z. E.D., ka pasur një aktivitet të ligjshëm, të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë arsye shuma e deklaruar nga subjekti si “hua” u përfshi paraprakisht në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Por, nuk provohet nëse ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të dhënë huan prej 10.000 euro dhe subjektit iu kalua barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të huas.

Komisioni, në analizën financiare, ka marrë në konsideratë edhe shpenzimet: a) shpenzimet e jetesës të përlogaritura sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja me të dhënat bazuar te INSTAT; b) shpenzimet për shkollimin janë marrë në konsideratë; duke u bazuar në lëvizjet bankare të subjektit; në vërtetimet zyrtare të Universitetit të Tiranës për subjektin; dhe të Universitetit *** të Tiranës për të birin, E.S.; c) shpenzimet për udhëtime janë bazuar në verifikimet e bëra në sistemin *TIMS*.

Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve të subjektit të kryera për shkak të detyrës, duke qenë se subjekti nuk kishte sjellë dokumentacion provues, iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

1.10 Analiza financiare lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën 2004 – 2010, reflektohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

| Përshkrimi | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|--|-------------------|-----------------|-------------------|-------------------|-----------------|------------------|-----------------|
| PASURI | 10 641 358 | 0 | 500 000 | 0 | 0 | 1 200 000 | 0 |
| Apartament në Tiranë | 9 885 720 | - | - | - | - | - | - |
| Autoveturë Benz, blerë në datën 2.6.2004 | 755 638 | - | - | - | - | - | - |
| Magazinë 10 m ² , datë 11.1.2006 | - | - | 500 000 | - | - | - | - |
| Autoveturë “Daimlerchrysler E270”, blerë në datën 9.2.2009 | - | - | - | - | - | 1 200 000 | - |
| DETYRIME | 4 182 420 | -612 700 | -1 113 327 | -1 088 190 | -615 913 | 0 | -651 487 |

¹⁵ Shkresa me nr. *** prot., datë 4.4.2019.

¹⁶ Subjekti ka dorëzuar shkresë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ku vërtetohet se z. E.D. ka pasur të regjistruar në emrin e tij një biznes të vogël me xhiro deri 2 milion lekë me aktivitetet “*tregti me pakicë materialesh ndërtimi*”, dhe se ka paguar detyrimet përkatëse. Nuk provohet se sa ka qenë fitimi neto i vëllait. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar edhe një printim të llogarisë bankare të z. E.D. ku provohet se ka pasur gjendje llogarie shumë prej rreth 920.000 lekësh të cilat nuk janë prekur deri në vitin 2009. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumente në emër të babait të saj, i cili e ka pasur këtë biznes përpara se të kalonte në emër të z. E.D. Nga këto të dhëna nuk provohet fitimi neto që kanë pasur përpara periudhës kur është dhënë huaja.

| | | | | | | | |
|--|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Detyrim për kontratën e sipërmarrjes së apartamentit, Tiranë | 4 182 420 | -1 838 100 | -1 113 327 | -1 088 190 | - | - | - |
| Detyrim marrë vëllait për blerjen e apartamentit | - | 1 225 400 | - | - | -615 913 | - | -651 487 |
| TË ARDHURA | 3 151 572 | 1 271 882 | 2 096 828 | 2 575 262 | 2 576 176 | 2 725 422 | 1 949 861 |
| Të ardhura nga paga, subjekti | 855 232 | 791 882 | 1 006 497 | 1 129 894 | 1 219 900 | 1 320 006 | 1 242 773 |
| Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit | 296 340 | 480 000 | 645 000 | 615 000 | 765 000 | 747 000 | 540 516 |
| Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 66 m ² , Shkodër | 2 000 000 | - | - | - | - | - | - |
| Të ardhura nga shitja e autoveturës (targa ***) | - | - | - | 250 000 | - | - | - |
| Të ardhura nga qiraja apartamentit në Tiranë | - | - | 445 331 | 580 368 | 591 276 | 658 416 | 166 572 |
| SHPENZIME | 375 856 | 541 774 | 893 455 | 1 174 487 | 956 678 | 1 274 853 | 1 600 674 |
| Shpenzime jetese | 375 856 | 438 228 | 438 228 | 696 288 | 546 480 | 546 480 | 546 480 |
| TIMS | - | 103 546 | 455 227 | 478 199 | 410 198 | 522 618 | 395 979 |
| Pagesë për studime, subjekti | - | - | - | - | - | - | 50 000 |
| Shpenzime shkollimi, E. S. | - | - | - | - | - | 205 755 | 208 215 |
| Shpenzime mobilimi | - | - | - | - | - | - | 400 000 |
| LIKUIDITETE NË FILLIM | - | - | 175 770 | 10 888 | 259 660 | 412 242 | 744 602 |
| Llog. në "BKT", E.S. (llog. personale) | - | - | - | - | 25 754 | 69 906 | 69 069 |
| Llog. në "Tirana Bank", Valbona Seknaj | - | - | 175 770 | 10 888 | 233 906 | 342 336 | 675 533 |
| LIKUIDITETE NË FUND | - | 175 770 | 10 888 | 259 660 | 412 242 | 744 602 | 658 099 |
| Llog. në "BKT", E.S. (llog. personale) | - | - | - | 25 754 | 69 906 | 69 069 | 68 231 |
| Llog. në "Tirana Bank", Valbona Seknaj | - | 175 770 | 10 888 | 233 906 | 342 336 | 675 533 | 589 868 |
| Cash ¹⁷ | - | - | - | - | - | - | - |
| DIFERENCA (TË ARDHURA –PASURI NETO – SHPENZIME) | -3 683 222 | -58 362 | -245 072 | 63 813 | 851 004 | -81 791 | -215 717 |

Për sa më sipër, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, u konstatua se:

- Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme, për periudhën 2004 – 2010, dhe paraqitet me një balancë financiare negative në shumën **- 4.284.244 lekë**, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

1.11 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet nga Komisioni

Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni duke pretenduar se:

Të ardhurat e saj nga paga dhe të ardhurat e bashkëshortit, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit janë përlogaritur në mënyrë të pasaktë:

Subjekti ka pretenduar se në të ardhurat nga puna e saj, nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga dietat për vitet 2004 – 2010¹⁸. Gjithashtu, ka pretenduar se të ardhurat e saj nga

¹⁷ Cash: Referuar deklaratës periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar në vitin 2004 gjendjen cash në shumën prej 300,000 lekësh, nga të ardhurat e mbartura nga një vit më parë, nga shitja e një automjeti tip "Ford" me targa ***. Në shkresën e DPSHTRR-së nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me pronësinë e një automjeti tip furgon, i shitur në vitin 2003, në emër të subjektit apo familjarëve të saj. Si rezultat, kjo shumë nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare të subjektit.

¹⁸ Bashkëlidhur prapësimëve vërtetim i datës 20.06.2019 i degës së buxhetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si pasaktësi që vjen nga hartuesi i dokumentit.

puna, të pasqyruara në dokumentet zyrtare për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, janë të pasakta, dhe ka kërkuar që të saktësohen nga Komisioni sipas vërtetimit të datës 20.6.2019, të lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit të Gjykatës Rrethit Gjyqësore Shkodër, si pasaktësi që vjen nga hartuesi i këtyre dokumenteve.

Në lidhje me të ardhurat e llogaritura për aktivitetin tregtar të bashkëshortit, subjekti ka pretenduar se për periudhën 1994 – 2007, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka vërtetuar vetëm pagesat e detyrimit tatimor ndër vite, si dhe ka listuar bazën ligjore mbi të cilën janë përlllogaritur këto shuma të paguara. Në lidhje me fitimin *neto* të realizuar për periudhën 2004 – 2007, nuk jepet informacion. Subjekti, gjithashtu, ka kundërshtuar marzhën e fitimit nga aktiviteti i bashkëshortit, të llogaritur nga Komisioni në vlerën 15 %, pasi pretendon se ky *marzh* fitimi i llogaritur nuk është i mbështetur në ligj.

Subjekti ka pretenduar se analiza financiare e Komisionit për të bërë llogaritjen e fitimit *neto* mbi bazën e një të dhënë, atë të tatimit të paguar (sipas *info* nga DRT-ja), me veprime shumëzimi në bazë të vlerës në lekë të tatimit vjetor të paguesit (me 15 % e supozuar si *marzh* fitimi), duke mos pasur asnjë të dhënë për xhiron, vetëm duke bërë kalkulime matematikore, përgjatë këtyre viteve nga 2004 – 2007, sipas *marzhit* të fitimit 15 %, mbi xhiron e supozuar të realizuar nga biznesi, është i gabuar dhe ka cenuar rëndë situatën financiare të subjektit, me të ardhurat e siguruara nga biznesi për këto vite.

Subjekti ka shpjeguar: *“Gjithë gama ligjore që aplikohet në rastin në fjalë, ka përcaktuar qartazi organin kompetent për të llogaritur, mbajtur dhe kontrolluar bizneset që është institucioni tatimorë. Detyrë të cilën ky institucion nuk e ka kryer sipas ligjit, për pasojë, unë, si qytetare nuk mund të dija sa ishte fitimi neto në këto vite, kur vetë kjo administratë nuk e ka përcaktuar. Kjo ka bërë që llogaritja e fitimit neto kryer nga Komisioni ka cenuar dukshëm të ardhurat e krijuara nga biznesi dhe duke i barazuar, këto të ardhura me një pagë minimale mujore, që është e paimagjinueshme dhe aspak logjike që një biznes të sigurojë të ardhura minimale jetese, madje dhe më pak se sa një i punësuar në administratën shtetërore. Në këto kushte situata financiare, e llogaritur jo sipas ligjit, dhe jo nga një organ i përcaktuar me ligj, ka rënduar me keqdashje situatën financiare”.*

Subjekti ka pretenduar se të ardhurat e bashkëshortit, për vitet 2004 – 2007, janë sa i ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore, dhe aq duhet të llogariten edhe nga Komisioni.

Në lidhje me të ardhurat e deklaruara, si të përfituara nga shitja e apartamentit në Shkodër me sip. 66 m², subjekti i ka qëndruar shpjegimeve që ka dhënë në pyetësorë, duke pretenduar se nuk jemi përpara hartimit të dy kontratave për shitjen e së njëjtës pasuri. Pra, nuk ndodhemi përpara fiktivitetit.

Subjekti ka pretenduar se kontrata e dytë ka të parashikuar gabim çmimin, i cili duhet të pasqyronte vetëm vlerën e kështit të fundit prej 1.000.000 lekësh. Depozitimi i aktit në ZVRPP është bërë nga blerësja, pasi sipas ligjit i takon asaj, për pasojë, subjekti nuk ka pse të jetë përgjegjës për veprimet konkrete të blerësit, e cila i ka pasur të dy kontratat, dhe është zgjedhja e saj se cilën dërgon në zyrën e regjistrimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka shmangur asnjë detyrim takse në ZVRPP-në Shkodër, shmangien e ka bërë vetë blerësja, dhe se konkluzioni i arritur nga Komisioni, si evazion fiskal, nuk duhet t'i ngarkohet në përgjegjësi subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezultoi se me kalimin e barrës së provës nga Komisioni, ka paguar tatimin në burim për shumën e plotë të shitjes prej 4.500.000 lekësh si e ardhur nga shitja¹⁹ e apartamentit.

¹⁹ Vërtetimi i DRT-së Shkodër, konferencë bankare.

Në lidhje me huadhënien nga z. E.D., subjekti ka shpjeguar se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme, sepse ka qenë pasues i aktivitetit të babait që nga viti 1994 e në vijim. Subjekti depozitoi dokumentacion²⁰ ku vërtetoheshin pagesat e tatimeve në mënyrë të rregullt nga babai i saj dhe më vonë nga i vëllai. Subjekti argumentoi se i vëllai ka pasur depozitë në shumën 920.000 lekë, fakt i konstatuar se nuk e ka prekur këtë shumë deri në vitin 2009. Kjo tregon se i vëllai ka pasur mundësi për të dhënë hua shumën prej 10.000 euro, si dhe të ardhurat e tij nga biznesi kanë qenë të mjaftueshme për ta ndihmuar subjektin me huan²¹ e dhënë.

Subjekti shpjegon se “nuk mund të llogaritet fitimi *neto* sot, kur me ligj i takon organit tatimor, i cili jo vetëm nuk e ka llogaritur në ato vite për të gjithë bizneset, por shkon dhe me tej, nuk ka ruajtur dokumentacionin tatimor që ka për detyrë t’i ruante sipas ligjit”.

Subjekti ka pretenduar se në analizën financiare nuk janë hequr shpenzimet e udhëtimit për shkak të detyrës.

Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti ka kundërshtuar shpenzimet e jetesës të llogaritura sipas standardit të INSTAT, sepse pretendon se minimumi jetik është shumë më i ulët se ai i llogaritur nga ILDKPKI-ja, dhe se vlerat e përdorura nga ILDKPKI-ja për këtë zë janë më të larta për të rritur zërin shpenzime jetike.

Subjekti ka kundërshtuar, gjithashtu, shpenzimet e udhëtimit të llogaritura nga Komisioni, duke pretenduar se shpenzimet për udhëtimet e saj dhe të familjes në Malin e Zi, duhet të llogariten më pak sepse: a) udhëtimet, kryesisht, janë bërë te familjarët e tyre; dhe b) shpenzimet e llogaritura nga Komisioni i referohen shpenzimeve të kryera në vendet e Bashkimit Evropian. Në këtë shtet shpenzimet janë më të ulta se në vendet e Bashkimit Evropian, për pasojë, subjekti kërkoi nga Komisioni që vlerësimi për udhëtimet në Mal të Zi të llogariten maksimumi në 20 euro/udhëtimi, vlerë sipas standardit të këtij vendi dhe jo sipas standardit Evropian.

1.12 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Në lidhje me pretendimin e subjektit për pasaktësitë të dokumenti vërtetues i pagës, Komisioni argumenton se: pagat për periudhën 2004 – 2010, për vitin 2004 janë marrë bazuar në vërtetimin e lëshuar nga institucioni përkatës, ndërsa për vitin 2005 e në vazhdim janë marrë në konsideratë të ardhurat e kaluara në llogarinë bankare të subjektit.

Komisioni vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës, janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës, dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i bashkëshortit, subjekti nuk dha informacion dhe as provoi se sa mund të ketë qenë *marzhi* i fitimit apo qarkullimi i realizuar nga aktiviteti i bashkëshortit. Subjekti nuk ka deklaruar sa ka qenë *marzhi* i fitimit nga ky aktivitet. Në mungesë të dokumentacionit referues ligjor nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, si dhe në mungesë të dokumentacionit provues nga subjekti, Komisioni u bazua në të dhënat zyrtare të dorëzuara nga institucioni tatimor (sipas vërtetimit të lëshuar nga DRT-ja Shkodër) për llogaritjen e *marzhit* të fitimit, ku mesatarisht, edhe pse rezulton në 14.4 %, Komisioni në analizën e kryer e ka përlllogaritur afërsisht 15 % *marzhin* e fitimit. Gjithashtu, në analizën

²⁰ Subjekti depozitoi dokumentacion në origjinal “fletë njoftim tatimi” dhe “mandatarkëtim” për “tatim dyqani” paguar nga babai, z. R.D. nga viti 1994 dhe në vijim.

²¹ Subjekti ka argumentuar se periudha e biznesit nga vitin 1994 i është nënshtruar rregullimit ligjor të ligjit nr. 7679/1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” në dispozitat e tij përcaktohet një tatim fiks dhe ligji 8313/1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” më pas është rregulluar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000, dhe ligjin nr. 8979, datë 12.12.2002 (tatim mbi xhiron), organi tatimor në *infor* e tij për bizneset nuk jep asnjë informacion me fitimin neto, por jep *infor* vetëm për tatimin që është paguar në shtet (fillimisht tatim fiks, ligji nr. 7679/12993 nga viti 2000 ligji nr. 8715/2000 tatim mbi xhiron).

financiare është përlllogaritur qarkullimi në bazë të tatimit të paguar, referuar vitit në të cilin janë deklaruar dhe paguar detyrimet respektive.

Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Shkodër, Komisioni arsyeton që jemi përpara faktit të hartimit të dy kontratave të shitblerjes për të njëjtën pasuri.

➤ **Komisioni ka konstatuar se, shprehja e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për lidhjen e dy kontratave për të njëjtën pasuri, si dhe ndërmarrja e veprime fiktive në ZVRPP-në Tiranë, me qëllim shmangien e të ardhurave të tatueshme për sa i takon regjistrimit të kontratës për kalimin e pronësisë, si dhe çmimit të rremë të transaksionit, janë veprime që cenojnë rëndë pastërtinë e figurës dhe të etikës së magjistratit.**

Pretendimi i subjektit se depozitimi i kontratave në ZVRPP dhe pagesa e tatimeve për të ardhurat e realizuara janë detyrime të blerësit nuk qëndrojnë për dy arsye: a) subjekti është nënshkruar me vullnet të plotë i dy kontratave për shitblerje pasurie, dhe kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia e pasojave që sjellin këto veprimet juridike pavarësisht se kush e depoziton aktin për regjistrim në ZVRPP; si dhe b) detyrimin e pagesës së tatimit mbi të ardhurat e tatueshme²² e ka pala shitëse, pra, ai që përfiton të ardhura dhe jo blerësi siç pretendon subjekti i rivlerësimit, referuar ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se vëllai ka pasur të ardhura të ligjshme, të cilat vijojnë që nga aktiviteti i babait të saj, Komisioni në administrim të dokumenteve të sjella në seancën dëgjimore, pranoi pretendimin e subjektit, dhe këto të ardhura i ka reflektuar si burime të ligjshme në analizën financiare. Komisioni vlerëson se me dokumentet e depozituara nga subjekti provohet se aktiviteti i të vëllait ka qenë një aktivitet i ligjshëm që vijon nga viti 1994 dhe detyrimet tatimore janë shlyer, por nuk provohet fitimi real nga aktiviteti i vëllait. Komisioni vlerëson se duke qenë që ka kaluar shumë kohe dhe subjekti është në pamundësi për të gjetur dokumentacion dhe në të njëjtën kohë, Komisioni nuk disponon referenca për të bërë një përlllogaritje të mundshme të fitimit, vlerësohet se nuk mund të penalizohet subjekti për shkak të pamundësisë për të provuar këto fitime, dhe në të njëjtën kohë, për shkak të faktit se administrata tatimore nuk mund të na informojë në lidhje me këtë informacion, në përputhje me pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se mosparaqitja e dokumenteve justifikues është për shkaqe të arsyeshme.

Lidhur me pretendimin e subjektit për heqjen nga analiza financiare të shpenzimeve të udhëtimit të subjektit për shkak të detyrës, Komisioni nuk reflektoi asnjë ndryshim në analizë për këtë zë shpenzimesh, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar pretendimet e saj.

Në lidhje me shpenzimet e jetesës, sipas ILDKPKI-së, të kundërshtuara nga subjekti, Komisioni vlerëson se shpenzimet e jetesës llogariten referuar korrespondencave zyrtare me ILDKPKI-në (sipas shkresës së fundit me nr. *** prot., datë 4.3.2019).

Në përfundim, nuk mund të merren në konsideratë pretendimet e subjektit, pasi shpenzimet e referuara sipas ILDKPKI-së, mbështeten në të dhënat e INSTAT dhe ky është standard i vendosur nga Komisioni.

²² Referuar ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8/dh, parashikon: “Neni 8, e ardhura e tatueshme, dh) *për qëllim të tatimit për të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme, të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme*”. Dhe neni 11/2, parashikon se, “*tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme....*”.

Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve, kryesisht në Mal të Zi, trupi gjykues vendosi të marrë në konsideratë, duke reflektuar në analizën financiare, pretendimet e subjektit në seancën dëgjimore që shpenzimet për udhëtim të përlogariten si vijon:

- 20 euro/person për udhëtime vajtje - ardhje brenda ditës nga subjekti dhe familjarët;
- 15 euro/person për rastet e udhëtimeve me mjete publike.

1.13 Rishikimi i analizës financiare pas prapësimeve të subjektit

Si rezultat i provave të dorëzuara nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në analizën financiare janë reflektuar ndryshimet në lidhje me:

- shpenzimet për udhëtime drejt Malit të Zi janë ulur në mesatarisht në 20 euro/udhëtimi;
- të ardhurat për vitin 2005 janë reflektuar sipas vërtetimit të gjykatës në shumën 933.815 lekë.

Tabela nr. 4

| Përshkrimi | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|--|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1. PASURI | 10 641 358 | 0 | 500 000 | 0 | 0 | 1 200 000 | 0 |
| Apartament në Tiranë | 9 885 720 | | | | | | |
| Autoveturë "Benz" blerë në datën 2.6.2004 | 755 638 | | | | | | |
| Magazinë me sip 10 m ² , datë 11.1.2006 | | | 500 000 | | | | |
| Autoveturë "Benz", blerë në datën 9.2.2009 | | | | | | 1 200 000 | |
| 2. DETYRIME | 4 182 420 | -612 700 | -1 113 327 | -1 088 190 | -615 913 | 0 | -651 487 |
| Detyrim për kontratën e sipërmarrjes së apartamentit, në Tiranë | 4 182 420 | -1 838 100 | -1 113 327 | -1 088 190 | | | |
| Hua marrë vëllait për blerjen e apartamentit | | 1 225 400 | | | -615 913 | | -651 487 |
| 3. PASURI NETO | 6 458 938 | 612 700 | 1 613 327 | 1 088 190 | 615 913 | 1 200 000 | 651 487 |
| 4. TË ARDHURA | 3 151 572 | 1 413 815 | 2 096 828 | 2 575 262 | 2 576 176 | 2 725 422 | 1 949 861 |
| Të ardhura nga paga subjekti | 855 232 | 933 815 | 1 006 497 | 1 129 894 | 1 219 900 | 1 320 006 | 1 242 773 |
| Të ardhura nga aktiviteti privat i E. S. (deklaruar) | 296 340 | 480 000 | 645 000 | 615 000 | 765 000 | 747 000 | 540 516 |
| Të ardhura nga shitja e apartamentit m sip. 66 m ² , në Shkodër | 2 000 000 | | | | | | |
| Të ardhura nga shitja e autoveturës (targa ***) | | | | 250 000 | | | |
| Të ardhura nga qiraja apartamentit në Tiranë | | | 445 331 | 580 368 | 591 276 | 658 416 | 166 572 |
| 5. SHPENZIME | 375 856 | 509 914 | 805 626 | 1 115 241 | 887 696 | 1 162 373 | 1 542 373 |
| Shpenzime jetese | 375 856 | 438 228 | 438 228 | 696 288 | 546 480 | 546 480 | 546 480 |
| TIMS | | 71 686 | 367 398 | 418 953 | 341 216 | 410 138 | 337 678 |
| Pagesë për studime subjekti | | | | | | | 50 000 |
| Shpenzime mobilimi | | | | | | | 400 000 |
| Shpenzime shkollimi E.S. | | | | | | 205 755 | 208 215 |
| 6. LIKUIDITETE NË FILLIM | 0 | 0 | 175 770 | 10 888 | 259 660 | 412 242 | 744 602 |
| Llogari "BKT", E.S. (llog personale) | 0 | 0 | 0 | 0 | 25 754 | 69 906 | 69 069 |
| Llogari "Tirana Bank", Valbona Seknaj | 0 | 0 | 175 770 | 10 888 | 233 906 | 342 336 | 675 533 |
| 7. LIKUIDITETE NË FUND | 0 | 175 770 | 10 888 | 259 660 | 412 242 | 744 602 | 658 099 |
| Llogari "BKT", E.S. (llog personale) | | | | 25 754 | 69 906 | 69 069 | 68 231 |
| Llogari "Tirana Bank", Valbona Seknaj | | 175 770 | 10 888 | 233 906 | 342 336 | 675 533 | 589 868 |
| Cash | | 0 | | | | | |
| DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7) | -3 683 222 | 115 431 | -157 243 | 123 059 | 919 986 | 30 689 | -157 496 |

➤ **Përfundimisht, pas ndryshimeve të reflektuara, në analizën financiare Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2004 -2010 ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën - 3.997.962 lekë.**

2. Tokë truall²³ me sip. 360 m², në fshatin Pulaj, Velipojë.

Vlera e deklaruar: 881.280 lekë.

Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi me bashkëshortin me ½ pjesë.

²³ Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë : certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 25.7.2012.; kontratë shitblerje nr. ***, datë 17.7.2012; certifikatë pronësie për tokën truall me sip. 360 m².

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.
 Mënyra e fitimit: kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.7.2012, me vlerë 881.280 lekë.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Shkodër²⁴ konfirmoi pasurinë në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortit.

2.2 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

Subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën “Vetting”, dhe as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në përgjigjet e pyetësorit²⁵ subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri, në bashkëpronësi me bashkëshortin, është blerë me kursimet e tyre familjare. Komisioni vëren se subjekti nuk ka specifikuar periudhën në të cilën këto kursime janë krijuar.

2.3 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2012

Të dhënat e analizuara, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2012, reflektohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 5

| | <u>Viti 2012</u> |
|--|------------------|
| Pasuri | 1 416 354 |
| Tokë, truall në Velipojë blerë më 25.7.2012 | 881 280 |
| Ndryshim i likuiditetit | 535 074 |
| Detyrime | - |
| (1) Pasuri neto (Pasuri - Detyrime) | 1 416 354 |
| (2) Të ardhura | 1 891 122 |
| Të ardhura nga paga subjekti | 1 083 036 |
| Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat) | 489 516 |
| Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortit | 318 570 |
| (3) Shpenzime | 1 235 895 |
| Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 697 740 |
| Shpenzime shkollimi, Xh.S. | 16 500 |
| Shpenzime TIMS | 371 655 |
| Shpenzime mobilimi | 150 000 |
| Rezultati (2-3-1) | - 761 127 |

Të ardhurat e vitit 2012

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, u konstatua se:

- i. për vitin 2012 shuma totale e të ardhurave nga paga e subjektit, e kaluar në llogarinë bankare, rezulton të jetë 1.083.036 lekë.
- ii. për sa i përket informacionit mbi të ardhurat nga aktiviteti privat i E.S. për vitin 2012, referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.11.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, fitimi *neto* rezulton të ketë qenë në shumën 489.516,3 lekë. Sipas dokumentit zyrtar nga DRT-ja Shkodër, vihet re se shumat e të ardhurave *neto* nga aktiviteti privat i E.S. për periudhën 2008 – 2016 nuk përputhen me shumat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike, si dhe në përgjigje të pyetësorit dërguar nga Komisioni. Për

²⁴ Shikoni për më tepër në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 19.12.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Shkodër.

²⁵ Shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2019.

qëllim të analizës financiare është marrë në konsideratë fitimi *neto*, për të cilin është paguar detyrimi tatimor sipas vërtetimit lëshuar nga DRT-ja Shkodër.

- **Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2012 ka rezultuar se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për të blerë tokën në fshatin Pulaj, Velipojë, ka balancë financiare negative për vitin 2012, në shumën - 761.127 lekë.**

2.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e saj, kundërshtoi për këtë pasuri analizën financiare të kryer nga Komisioni, për sa i përket:

- shpenzimeve jetike sipas INSTAT dhe jo sipas ILDKPIKI-së;
- shpenzimet sipas sistemin *TIMS* të llogariten sipas pretendimeve së saj;
- ka kërkuar vënien e likuiditeteve të mbartura nga viti 2011, që nuk janë pasqyruar nga Komisioni, por që duheshin përfshirë.

2.5 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Komisioni, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, pranoi pretendimet e subjektit për sa i përket shpenzimeve për udhëtim në Mal të Zi, duke reflektuar këto ndryshimeve në analizën financiare.

Në lidhje me përfshirjen në analizën financiare të gjendjes së likuiditeteve jo të sakta, pas vlerësimit të argumenteve të paraqitur nga subjekti, Komisioni argumenton se analiza financiare përfshin gjendjen e likuiditeteve në banka, jo vetëm për llogarinë e subjektit, por edhe të bashkëshortit të saj dhe të djalit. Si rezultat, gjendja e likuiditeteve në analizë nuk ndryshon. Shpenzimet e llogaritura sipas standardit të ILDKPKI-së mbeten të pandryshuara, sipas arsyetimit të bërë për pasurinë e trajtuar në pikën 1, sa më sipër. Shpenzimet për udhëtim ulen në shumën 290.618 lekë.

Tabela nr. 6

| | 2012 |
|--|------------------|
| Pasuri | 1 416 354 |
| Tokë, truall në Velipojë blerë në 25.7.2012 | 881 280 |
| Ndryshim i likuiditetit | 535 074 |
| Detyrime | - |
| (1) Pasuri neto (Pasuri - Detyrime) | 1 416 354 |
| (2) Të ardhura | 1 891 122 |
| Të ardhura nga paga subjekti | 1 083 036 |
| Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat) | 489 516 |
| Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortit | 318 570 |
| (3) Shpenzime | 1 154 858 |
| Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 697 740 |
| Shkollimi i djalit, Xh.S. | 16 500 |
| Shpenzime <i>TIMS</i> | 290 618 |
| Shpenzime mobilimi | 150 000 |
| Analiza (2-3-1) | - 680 089 |

Nga vlerësimi i analizën financiare të kryer, pretendimeve të subjektit, si dhe duke reflektuar ndryshimet, rezulton se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për të blerë tokën në fshatin Pulaj, Velipojë, pasi ka balancë financiare negative për vitin 2012 në shumën - 680.089 lekë.

- Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Investim në ndërtesë²⁶ 2-katëshe, me sip. 100 m², në fshatin Pulaj, Velipojë. Investim i pandarë në bashkëpronësi me bashkëshortin dhe me investitor z. N.M.

Vlera e deklaruar: Nuk ka investim nga subjekti dhe nga personit i lidhur bashkëshorti.
Pjesa në përqindje: Subjekti me bashkëshortin zotërojnë 50 % dhe investitori 50 %.
Burimi i krijimit: Sipas deklarimit në deklaratën “Vetting”: investitor N.M., në shkëmbim të dhënies së tokës ka bërë investimin mbi këtë truall. Nuk është bërë asnjë shpenzim nga subjekti.
Deklarimi sipas DPV: Investim, truall me sip. 360 m² me investitor M. dhe N.M. sipas aktmarrëveshjes së investimit nr. ***, datë 31.12.2012 (me shpenzimet e investitorit filluar punimet në vitin 2013, në ndërtim).
Mënyra e fitimit: Me aktmarrëveshjen e investimit nr. ***, datë 31.12.2012, e konfirmuar me deklaratën noteriale në datën 15.8.2014 për legalizim, me investitor N.M. kundrejt dhënies së tokës për investim.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Ndërmjet Valbona dhe E.S., në cilësinë e pronarëve të truallit dhe N.M. në cilësinë e investitorit, është nënshkruar një marrëveshje investimi nr. ***, datë 31.12.2012, sipas të cilës në këmbim të ½ së sipërfaqes truallit në pronësi të tyre do të kryhet investimi i ndërtimit të një godine 2-katëshe nga investitori N.M. Pas përfundimit të ndërtimit trualli dhe ndërtimi do ndaheshin në dy pjesë nga ku ½ do kalonte në pronësi të N.M. dhe ½ tjetër do regjistrohej në pronësi të E. dhe Valbona Seknaj.

ALUIZNI Zonat Turistike²⁷, informon se E.Xh.S.dhe Valbona R. Seknaj për dosjen nr. *** prot., datë 17.7.2013, janë pajisur me leje legalizimi. Bashkëlidhur leja e legalizimit nr. ***, datë 19.10.2018, lëshuar në emër të E.Xh.S., Valbona R. Seknaj dhe N.M., për legalizimin e ndërtimit me sip. 205.66 m², me 2 kate mbi tokë. Në dosje figuron e bashkëlidhur kërkesa për legalizim nr. *** prot, datë 17.7.2013, certifikatë familjare e subjektit, certifikatë pronësie e tokës, foto të objektit në karabina.

Kërkesa për legalizimin e ndërtimit pa leje nr. *** prot., datë 17.7.2013, është paraqitur nga kërkuesi, z. E.S., me adresë Velipojë, përshkrimi i objektit: “*ndërtim pa leje për shtëpi banimi, sip. bazë e ndërtimit pa leje 100 m² dhe sip. e përgjithshme e ndërtimit pa leje 200 m². Numri i kateve mbi tokë 2*”. Nga aktet e dosjes rezulton se në momentin e paraqitjes së kërkesës për legalizim nga E.S., godina ishte ngritur 2 kate (karabina) e pa përfunduar.

Nga verifikimi i akteve rezultoi se aplikues pranë ALUIZNIT Shkodër, për legalizimin e objektit, ka qenë vetëm bashkëshorti i subjektit, z. E.S., i cili ka vetëdeklaruar se sipërfaqja e

²⁶ Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë : aktmarrëveshje nr. ***, datë 31.12.2012, midis M. M., si investitore dhe Valbona e E. Seknaj si porosites sipas së cilës pala investitore do të bëjë një shtëpi banimi dy katëshe mbi tokën e dhënë nga pala porositesë dhe në përfundim të objektit pronarët e truallit do të marrin 50 % të sipërfaqes së ndërtimit dhe 50 % investitori. Afati i ndërtimit 24 muaj nga fillimi i punimeve mbi truallin. Vlera e investimit është llogaritur të jetë rreth 2.000.000 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 25.7.2012, për truallin me sip. 360 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi E. dhe Valbona Seknaj; deklaratë mbi rikonfirmimin e aktmarrëveshjes pronarë trualli – investitor nr. ***, datë 15.8.2014, nga N.M. (djali i M.M.) i cili rikonfirmon dhe deklaron se është plotësisht dakord me gjitha pikat e aktmarrëveshjes së lidhur midis M.M. dhe E. e Valbona Seknaj; kërkesë për legalizim nr. *** prot, datë 17.7.2013, nga E.S. për legalizimin e shtëpi banimi me sip. bazë ndërtimi 100 m², sip. e përgjithshme ndërtimi 200 m², numri i kateve 2.

²⁷ Shikoni në dosje shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2018, ardhur nga ALUIZNI, Drejtoria e Përgjithshme.

përgjithshme e ndërtimit pa leje/shtesës informale është 200 m², kurse në deklaratat e interesave ndër vite dhe në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se pjesa takuese është 50 %.

ZVRPP Shkodër²⁸, informoi se në emër të E. dhe Valbona Seknaj rezultojnë pasuritë:

- Pasuria truall plus ndërtesë me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***; si dhe
- Pasuria truall plus ndërtesë me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***.

Nga verifikimi i dokumentacionit depozituar nga **ZVRPP-ja Shkodër**²⁹, ka rezultuar:

- Ndërmjet E. dhe Valbona Seknaj, në cilësinë e dhuruesve, dhe N.M. në cilësinë e pranuesit të dhurimit, është nënshkruar një kontratë dhurimi nr. ***, datë 09.10.2018. Sipas këtij akti palët kanë rënë dakord që të dhurojnë ½ pjesë ideale të pandarë/mbi pronën ½ pjesë trualli. Palët theksojnë se shkak i dhurimit të kësaj pjese prone është objekti shtëpi banimi 2-katëshe – ndërtuar mbi këtë truall – ndërtim informal në procedurë legalizimi – investim i investitorit N.M., mbi këtë truall. Në respektim të aktmarrëveshjes nr. ***, datë 31.12.2012, me investitorin, dhuruesit dhurojnë pjesën prej ½ të pa ndarë të truallit me sip. 360 m², pranuesit të dhurimit N.M., për efekt të përfshirjes së tij si bashkëpronarë trualli në procedurë legalizimi.
- E gjithë prona do të regjistrohet në favor të: E.S. ¼ pjesë; Valbona Seknaj ¼ pjesë; dhe N.M. 2/4 pjesë takuese ideale të pandarë të pasurisë së mësipërme.
- Nga ZVRPP-ja Shkodër, konfirmohet pasuria truall me sip 360 m², e regjistruar në datën 11.10.2018, në emër të tre bashkëpronarëve: E. dhe Valbona Seknaj bashkëpronar me 2/4 e pasurisë dhe N.M. bashkëpronar me 2/4 pjesë.
- Gjithashtu, rezulton dhe certifikata për vërtetim pronësie me nr. ***, datë 16.10.2018, për pasurinë me sip. 360 m², nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, në fshatin Pulaj, në pronësi të 3 personave të cituar më sipër.
- Gjithashtu, në dosje rezulton dhe leje legalizimi, nr. ***, datë 19.10.2018, për objekt banimi, me sip. ndërtimore 121.89 m², sip. e ndërtimit 88.95 m² dhe sip. totale e ndërtimit për banim 205.66 m², me 2 kate mbi tokë, e cila i jepet E.S., Valbona Seknaj dhe N.M. Lejes së legalizimit i bashkëlidhet praktika e ALUIZN-it që i përcillet ZVRPP-së për regjistrim të ndërtesës së legalizuar.
- Në dosje rezulton certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.12.2018, e pasurisë me nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. trualli 121.89 m² dhe me sip. ndërtesë 88.95 m² në emër të 3 bashkëpronarëve. Në kartelën e pasurisë rezulton e përshkruar pasuria truall me sip. 121.89 m² dhe ndërtesë me sip. 88.95 m². Te përshkrimet e veçanta të pronës është pasqyruar: leje legalizimi nr. ***, datë 19.10.2018, objekt banimi 2 kate, kati përdhe me sip. 88.95 m² dhe kati i parë me sip. 116.71 m².
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.12.2018, e pasurisë me nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të 3 bashkëpronarëve.

Nga hetimi i kryer Komisioni konstatoi se as subjekti i rivlerësimit dhe as sipërmarrësi/investitor, nuk kanë aplikuar për t'u pajisur me leje ndërtimi për godinën 2-katëshe, në Velipojë, përpara se të niste ndërtimin e kësaj godine. Në fazën kur ishte bërë një pjesë e investimit (në nivel karabinaje) është bërë aplikimi për legalizim nga bashkëshorti i subjektit.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2018.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2018.

Në përgjigjet e pyetësorit³⁰, subjekti ka shpjeguar: “Nuk kam aplikuar për leje ndërtimi, pasi investitori ishte N.M. Si pronarë të truallit me sip. 360 m² është aplikuar për leje legalizimi nga bashkëshorti E.S.. ...ndërtimi ka filluar në vitin 2013 dhe ka përfunduar në vitin 2014. Në datën 10.12.2014, kemi lidhur kontratë me OSHEE-në dhe më datë 23.6.2015, kemi lidhur kontratën me Ujësjellës Kanalizime. Për herë të parë është bërë e përdorshme në verën e vitit 2015. Ndërtimi është bërë nga investitori N.M., për të cilën ka depozituar situacionet sipas të cilës, deklarohet se investimi në total është në vlerën 5.373.356 lekë, nënshkruar nga ndërtuesi Gj.Ll., si dhe dokumentin e marrjes së pagesave nga Gj.Ll. sipas situacionit përmbledhës, që tregon se pagesa është bërë nga investitor/porositës N.M. dhe nëna e tij M.M. që ka bërë veprimet për likuidimin e shumave të investimit në datën 1.10.2014”.

- **Komisioni, në lidhje me pasurinë godinë 2-katëshe me sip. 200 m², mbi truall me sip. 360 m², në fshatin Pulaj, Velipojë, ka konstatuar se subjekti ka kryer ndërtim të paligjshëm në vitin 2013. Ndërtimet e paligjshme nga dhjetori i vitit 2014, parashikohen si vepër penale referuar nenit 199/a të Kodit Penal, të Republikës së Shqipërisë.**

3.2 Në lidhje me vlerën e investimit për ndërtimin e godinës 2-katëshe

Subjekti ka deklaruar se ndërtimi i kësaj godine është kryer nga investitori N.M. Subjekti, me kërkesë të Komisionit, ka depozituar dokumentacion ligjor, për të provuar burimin e ligjshëm për vlerën e investimit ndërtim godine 2-katëshe.

Sipas deklarimeve të subjektit ky investim është kryer gjatë viteve 2013 – 2014 dhe vlera e investimit është deklaruar në shumën 5.373.356 lekë. Sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, situacionet e ndërtimit janë në vlerat, sa më poshtë vijon:

- Situacioni 1 - punime xokolature në vlerën 581.417 lekë (paguar *cash* në datën 22.4.2013);
- situacioni 2 - punime të katit përdhe në vlerën 2.134.999 lekë (paguar *cash* në datën 15.11.2013);
- situacioni 3 - punime të katit të parë në vlerën 2.656.940 lekë (paguar *cash* në datën 1.10.2014)

Komisioni verifikoi të dhënat zyrtare të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) në lidhje me koston mesatare të ndërtimit sipas qyteteve. Referuar udhëzimeve përkatëse³¹, kosto mesatare e ndërtimit të objektit duhej të ishte minimalisht në shumën prej 30.889 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi për vitin 2013, dhe 32.861 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi për vitin 2014. Referuar të dhënave zyrtare³², kosto mesatare për ndërtimin e objektit duhet të ishte minimalisht në vlerën totale prej 6.555.412 lekësh.

Nga analiza e Komisionit rezultoi se situacionet që ka depozituar subjekti në total janë me vlera më të ulëta se kostoja minimale e ndërtimit sipas udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave.

Subjekti, në lidhje me mobilimin e vilës, ka deklaruar: “Arredimi i banesës është bërë në një kat të saj nga N.M. (investitori), ndërsa kati tjetër është i pa arreduar”. Subjekti nuk deklaroi vlerën e mobilimit dhe kohën kur është kryer.

³⁰ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2019.

³¹ Udhëzim nr. 1, datë 08.5.2013 dhe Udhëzim nr .2, datë 6.8.2014. <http://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>

³² Sipas udhëzimeve, nuk përfshihen në vlerën e koston mesatare vlerat e: rrjetit inxhinierik; projektit; studimit gjeologjik dhe sizmik; lejes së ndërtimit; dhe truallit.

3.3 Në lidhje me burimin e ligjshëm për ndërtimin e godinës 2-katëshe

Subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm për të ardhurat e investitorit z. N.M., për ndërtimin e godinës 2-katëshe.

Referuar akteve të dorëzuara në përgjigje të pyetësorit, rezulton se z. N.M. figuron i punësuar në shtetin italian që nga viti 1998 e në vijim, me një përbërje familjare prej 4 personash.

Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të të ardhurave të z. N.M. Bazuar në të ardhurat e dokumentuara dhe përbërjes familjare të z. M., Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet minimale jetike dhe mundësinë për kursim për vitet 2005 - 2014³³. Të dhënat e marra në sistemin online të Institutit Italian të Statistikave³⁴ janë reflektuar në tabelën si mëposhtë:

Tabela nr. 7

| Viti | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | Total |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------|--------------|--------------|
| Të ardhurat vjetore sipas dokumentacionit zyrtar | 17 238 | 18 850 | 18 627 | 19 943 | 22 789 | 21 367 | 21 909 | 22 412 | 22 913 | 23 456 | 209 504 |
| Minimumi jetik për familje me katër persona | 15 504 | 15 852 | 16 116 | 17 196 | 17 676 | 17 784 | 18 204 | 19 248 | 19 584 | 19 284 | 176 448 |
| Mosha e bashkëshortes | 34 | 35 | 36 | 37 | 38 | 39 | 40 | 41 | 42 | 43 | |
| Mosha fëmija 1 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | |
| Mosha fëmija 2 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | |
| Të ardhura minus shpenzimet jetike | 1 734 | 2 998 | 2 511 | 2 747 | 5 113 | 3 583 | 3 705 | 3 164 | 3 329 | 4 172 | 33 056 |
| Shpenzim - likuidim situacionesh | | | | | | | | | 2 716 416 | 2 656 940 | 5 373 356 |
| Situacionet në euro | | | | | | | | | 19 374 | 18 963 | 38 337 |

Në analizën financiare të kryer janë përfshirë vetëm të ardhurat e z. N.M., sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga analiza e kryer ka rezultuar se, Z. N.M. në 10 vitet e fundit ka pasur të ardhura të ligjshme, por janë të pamjaftueshme për të ndërtuar objektin godinë 2- katëshe, në vlerën **- 5.281 euro** (38.337 - 33.056), si dhe vlerën e mobilimit.

Pranë ALUIZNI-t është kërkuar legalizimi i këtij ndërtimi të paligjshëm nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. E.S., ndërsa leja e legalizimit mban emrat e subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortit të saj dhe të investitorit N.M.

Komisioni, për sa më sipër, ka konstatuar se:

- **investitori N. M., si “personi tjetër i lidhur”, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ka të ardhura të ligjshme, por janë të pamjaftueshme për ndërtimin dhe mobilimin e kryer prej tij;**
- **ndërtim të paligjshëm për godinën 2-katëshe, ndërtuar në vitet 2013 - 2014, i legalizuar në vitin 2018.**

3.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet

³³ Të ardhurat e përfituara nga z. N.M., përpara vitit 2005, nuk janë marrë në konsideratë, pasi janë pranë nivelit të minimumit jetik, krahasuar me të ardhurat e përfituara në 10 vitet e fundit, për të cilat ka referencë zyrtare në lidhje me minimumin jetik.

³⁴ <https://www.istat.it/it/dati-analisi-e-prodotti/contenuti-interattivi/soglia-di-poverta>

Subjekti kundërshtoi analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe argumentoi se z. N.M., sipas dokumentacionit provues, është banor në Komunën “Rocca Di Papa” në shtetin italian, e cila është një zonë ku banojnë 17.294 banorë dhe minimumi jetik duhet të llogaritet më i ulët se sa është përlllogaritur nga Komisioni.

Subjekti ka kryer vetë analizën financiare, duke iu referuar të ardhurave të minimumit jetik nga viti 2005 – 2014 për zonën në komunën “Rocca Di Papa” dhe ka rezultuar se totali i të ardhurave të z. N.M. është 40.892 euro. Subjekti ka sqaruar se analiza financiare e kryer është bërë mbi bazën e të ardhurave të z. N.M. Po të përfshihen dhe të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij, e cila ka kontribut shtesë për familje me 4 persona, do të rezultojë një vlerë tjetër në rritje. Subjekti argumentoi se nga kjo analizë provohet se investitori mbulon vlerën e ndërtimit në shumën 38.337 euro.

Subjekti ka kryer llogaritje për vitet 1998 - 2004, duke përdorur të njëjtën metodë, në progresion aritmetik në zbritje nga 2004 - 1998, që nuk është përlllogaritur nga Komisioni (me argumentimin se të ardhurat e z. N.M. në këtë periudhë janë pranë nivelit të minimumit jetik dhe ishte e pamundur që ky person të kishte mundësi të kursente).

Subjekti ka argumentuar se në faqen e INSTAT- Italian, ku merren këto referenca, për këto vite mungojnë të dhëna pasi faqja ka të dhëna për 10 vitet e fundit dhe pastaj ato fshihen automatikisht.

Në lidhje me ndërtimin e paligjshëm subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka bërë ndërtim të paligjshëm, pasi ndërtimi është kryer nga investitori N.M., dhe për pasojë nuk është subjekt i veprës penale të parashikuar në nenin 199/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër që vepra penale e parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal (ndërtim në tokën e vet) është amnistuar me ligjin 22/2014, “Për dhënie amnistie”.

3.5 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me përlllogaritjet për minimumin jetik, nuk janë të pranueshme dhe për këto arsye i është referuar të dhënave të publikuara nga faqja zyrtare e INSTAT Italian, ku llogaritja e shpenzimeve për minimumin jetik është bërë sipas standardit të këtij institucioni.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se rezultati do ishte në rritje, nëse do të përfshiheshin dhe të ardhurat e bashkëshortes së z. N.M., Komisioni arsyeton se subjekti nuk provoi me dokumentacion të ardhurat e bashkëshortes së investitorit.

Komisioni vlerëson se aplikimi pranë ALUIZNI-t për legalizimin e këtij ndërtimi është bërë nga bashkëshorti i subjektit dhe ndërtimi ishte në nivel karabinaje, për pasojë ishte konsumuar veprimi i ndërtimit të paligjshëm dhe nuk mund të pranohet pretendimi i subjektit se ndërtimi i paligjshëm ishte kryer nga investitori. Deri në momentin e aplikimit për legalizim, investitori nuk kishte kryer asnjë veprim juridik që ta lidhte atë me ndërtimin e paligjshëm. Gjithashtu, nuk u provua nga subjekti i rivlerësimit që pagesat për investimin të jenë kryer nga z. N.M.

Në lidhje me argumentin që parashtron subjekti se vepra penale e parashikuar në nenin 199/a në Kodin Penal (ndërtim në tokën e vet) është amnistuar me ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, Komisioni, arsyeton se qëllimi i ligjit për amnistinë ishte të përjashtonte nga vuajtja e dënimit të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji. Ndërkohë, që vepra penale e ndërtimit të paligjshëm, vazhdon të jetë e dënueshme.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi me dokumentacion se investitori N.M. ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për ndërtimin e godinës 2-katëshe + mobilim.

Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues, çmon se pretendimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi subjekti nuk provoi burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë godinë 2-katëshe, ndodhur në Velipojë.

- Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe shqyrtimit të rrethanave në tërësi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Deklarimi i të ardhurave

4.1 Të ardhurat e përfituara në vite nga subjekti i rivlerësimit të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

- Të ardhurat nga paga si ndihmëse ligjore në zyrën e ndihmës juridike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën nga 1.9.1989 - 1.11.1990, s’ka dokumentacion (djegur në trazirat e vitit 1997 - 1998), vërtetim negativ datë 17.10.2016, vërtetim datë 27.10.2016 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, janë përlogaritur 650 lekë/muaj x 14 muaj = 9.100 lekë (nga kujtesa subjektit).
- Të ardhurat si avokate për periudhën 1.11.1990 – 25.8.1992 (mungon informacion, djegur në trazirat e vitit 997) 1.100 lekë/muaj x 22 muaj = 24.200 lekë (nga kujtesa e subjektit).
- Të ardhurat si person fizik avokat, e regjistruar në DRT-në Shkodër me vendim gjykate nr. ***, datë 25.8.1992, konfirmuar periudha nga 25.8.1992 - 31.12.1992, në vlerën 600.000 lekë sipas informacionit të ardhur nga DRT-ja Shkodër, nr. ***, datë 24.10.2016.
- Të ardhurat nga avokatia për periudhën 1.1.1993 – 31.12.1997.
- Të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhën nga 1.6.1998 - 31.10.2013 (sipas vërtetimit për pagën lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit të Gjykatës së Rrethit Shkodër), në vlerën 13.601.902 lekë.
- Të ardhura nga paga si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nga data 1.11.2013 - 31.12.2016, sipas të dhënave nga “Tirana Bank”, në vlerën 3.967.916 lekë.
- Të ardhurat si lehtësonjëse në Shkollën e Magjistraturës, vërtetim nr. *** prot, datë 26.10.2016, në vlerën 12.288 lekë.
- Të ardhurat nga qiraja e apartamentit³⁵ të banimit në Tiranë, për periudhën 2.4.2006 - 2.4.2010 sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 11.3.2006, në vlerën 400 euro/muaj x 48 muaj = 19.200 euro gjithsej.
- Të ardhurat nga shitja e apartamentit³⁶ me sip. 66 m², në Shkodër, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 5.11.2004, në vlerën 4.500.000 lekë.

4.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ISSH-ja³⁷ konfirmon pagat *bruto* dhe *neto* të znj. Valbona Seknaj (Durrraj) për periudhën 2012 – 2016, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si dhe pagesat nga Shkolla e Magjistraturës. Sipas konfirmimit të ISSH-së

³⁵ Trajtuar më sipër tek burimi i krijimit të pasurisë apartament në Rr. “***”.

³⁶ Trajtuar më sipër tek burimi i krijimit të pasurisë apartament në Rr. “***”.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

rezulton se shuma e të ardhurave për periudhën 1.1.2013 - 31.12.2016 nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë Shkodër është në vlerën 3.439.612 lekë.

DRT-ja Shkodër³⁸, konfirmon se znj. Valbona R. Seknaj (Durrnjaj) ka hapur aktivitet me vendim gjykate nr. ***, datë 25.8.1992, me kod fiskal *** dhe është çregjistruar në datën 31.12.1997.

Pagesat sipas dosjeve në vite janë:

| Viti, | pagesat ndër vite (lekë) |
|-------|--------------------------|
| 1992 | 15.000 |
| 1993 | 36.000 |
| 1994 | 40.000 |
| 1995 | 40.000 |
| 1996 | 40.000 |
| 1997 | 40.000 |

DRT-ja Shkodër³⁹, konfirmon se për subjektin Valbona R. Seknaj me kod fiskal *** nuk ka informacion mbi xhiron dhe fitimin e realizuar për vitet 1992 deri 1997, por vetëm për pagesat e kryera për këto vite.

Bashkia Shkodër⁴⁰, konfirmon se z. E.Xh.S. me NIPT *** është i regjistruar si taksapagues në Bashkinë Shkodër – detyrime ndaj Bashkisë Shkodër nuk ka. Statusi i këtij biznesi është aktiv. Znj. Valbona Seknaj (Durrnjaj) nuk është e regjistruar si taksapagues në Bashkinë Shkodër.

Tabela nr. 8

| Valbona Seknaj (Durrnjaj) | | | |
|---|------------------------|--------------------------------|----------------------------|
| Funksioni | Viti | Te ardhura te deklaruar veting | Te ardhura te dokumentuara |
| Ndihmës ligjore në Gjykatën Shkodër | 01/09/1989-17/10/1990 | 9100 | 0 |
| Avokat pranë Kolegjit të Avokateve Shkodër | 01/11/1990-25/08/1992 | 24,200 | 0 |
| PF/Avokat | 25/02/1992-31/12/1992 | 600,000 | 135,000 |
| PF/Avokat | 1993 | 1,200,000 | 324,000 |
| PF/Avokat | 1994 | 1,200,000 | 360,000 |
| PF/Avokat | 1995 | 1,300,000 | 360,000 |
| PF/Avokat | 1996 | 1,300,000 | 360,000 |
| PF/Avokat | 1997 | 1,200,000 | 360,000 |
| Gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër | 01/06/1998-31/10/20132 | 13,601,902 | 13,426,139 |
| Gjyqtare në Gjykatën Administrative Shkodër | 01/11/2013-31/12/2016 | 3,967,916 | 3,885,796 |
| Total | | 24,403,118 | 19,210,935 |

Komisioni ka verifikuar të ardhurat e subjektit nga “avokatia” për periudhën 1992 – 1997, të cilat janë në vlerë totale rreth 6.824.000 lekë. Referuar dokumentacionit justifikues të paraqitur

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2019.

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

nga subjekti dhe konfirmimeve të ardhura nga institucionet përkatëse nuk rezultojnë këto të dhëna.

4.3 Në lidhje me të ardhurat e deklaruar nga subjekti

Të ardhurat e deklaruara nga subjekti, si të përfituara nga aktiviteti privat i avokatisë, janë në shumën rreth 6.800.000 lekë, por nga dokumentacioni i administruar në dosje kanë rezultuar në shumën prej 1.899.000 lekë, fakt për të cilën subjekti iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

4.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare duke shpjeguar se për vitet e punës 1.09.1989 - 17.10.1990 si këshilltari ligjor, ka depozituar vërtetimin negativ të Ministrisë së Drejtësisë, ku konfirmon fillimin e saj në detyrë, por nuk konfirmon pagën, dokumentacioni nuk mund të riprodhohet pasi është djegur në trazirat e vitit 1997/98, për pasojë ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentet referuar nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Për vitet 01.11.1990 - 25.08.1992, pranë Kolegjit të Avokatisë Shkodër⁴¹, subjekti argumentoi se nuk ka dokumentacion provues pasi godina e kolegjit ka qenë në ambientet e gjykatës dhe subjekti sërish shpjegon se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive referuar nenit 32, të ligjit 84/2016.

Në lidhje me të ardhurat si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitet 1.06.1998 - 31.10.2013, në shumën 13.601.902 lekë, dokumentuar me vërtetimin lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit, vlerësoj se duhen korrigjuar të ardhurat në total për këto vite. Subjekti ka depozituar vërtetimin e datës 20.6.2019 të po kryetarit të degës së buxhetit, ku në total shuma për këto vite është 13.693.684 lekë⁴² (ku përfshihen dhe dietat).

Në lidhje me të ardhurat si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për vitet 31.10.2013 – në vijim, depozituar në deklaratën “Vetting”, në shumën totale 3.967.916 lekë, dokumentuar sipas vërtetimit të lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit, vlerësoj se duhen korrigjuar të ardhurat në total për këto vite⁴³. Subjekti ka kërkuar që të merren në konsideratë pretendimet e saj dhe të administrohet vërtetimi i datës 20.6.2016 lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe atë të datës 20.2.2019 të lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit, pranë Gjykatës Administrative Shkallës së Parë Shkodër.

Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga avokatia për periudhën 25.2.1992 – 31.12.1997, subjekti ka argumentuar se janë të ardhura të ligjshme, të tatueshme, të likuiduara dhe se janë aq sa janë deklaruar në deklaratën “Vetting”, pra, në shumën 6.800.000 lekë.

Subjekti shpjegoi se ka ushtruar një aktivitet të ligjshëm dhe sipas ligjit të kohës nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, për vitet 1992 -1997 tatimi ka qenë me tarifë fikse, në masën 40.000 lekë në vit, i ndarë në 4 këste, tre mujore. Sipas këtij ligji subjekti argumenton se në asnjë dispozitë të tij nuk parashikohet *marzhi* i fitimit 80 % që është përcaktuar nga Komisioni në analizën financiare.

Gjithashtu, subjekti argumenton : “*Në dokumentin e lëshuar nga DRT-Shkodër nuk ka asnjë informacion mbi fitimin neto që pretendohet nga Komisioni, pasi është llogaritur në*

⁴¹ Ligji nr. 7382, datë 8.5.1990, "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë". Neni 3, avokatët bashkohen në kolegjet e miratuara nga Ministria e Drejtësisë i cili përcakton dhe juridiksionin ku shëhet veprimtaria e tyre. Kolegji i avokateve është person juridik neni 13. Ndhimë juridike jepet kundrejt pagesës në bazë të tarifave të caktuara nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe arkëtohet për llogari të kolegjeve. Në rastet e veçanta, të parashikuara në rregulloren e avokatisë, ndihma juridike mund të jepet falas. Mënyra e ndarjes së të ardhurave caktohet me rregulloren të Ministrisë së Drejtësisë. Avokatet gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore shtetërore.

⁴² Vërtetim page, datë 20.6.2019, nga kryetari i degës së buxhetit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, periudha 1.6.1998 – 31.10.2013.

⁴³ Subjekti depoziton në cilësinë e provës vërtetimin e datës 20.6.2019 nga kryetari i degës së buxhetit, ku në total shuma për periudhën 1.11.2013 – 31.12.2016 është shuma 4.122.937 lekë⁴³ (përfshirë edhe dietat).

kundërshtim me ligjin e kohës. Llogaritja e marzhit të fitimit 80% për avokatët është një llogaritje matematikore dhe jo ligjore. Ky orientim i Komisionit, për të bërë llogaritjen e fitimit neto mbi bazën e një të dhënë atë të tatimit të paguar (sipas info nga DRT-ja), me veprime shumëzimi mbi bazën e vlerës në lekë të tatimit vjetor të paguar (me 80 % e supozuar marzh fitimi), duke mos pasur asnjë të dhënë për xhiron, vetëm duke bërë kalkulime matematikore, është jo vetëm antiligjore, por ka cenuar situatën financiare të subjektit, me të ardhurat e siguruara nga biznesi për këto vite. Për pasojë të argumenteve të mësipërme Komisioni duhet të ndryshojë analizën financiare dhe të marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara sipas deklaramit të subjektit”.

4.5 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Subjekti kundërshtoi analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se duhet të përfshihen të ardhurat e përfituara në vite edhe për ato vite që për sa ka arsyetuar në shpjegime nuk disponohet dokumentacion për shkak të djegies së arkivës së gjykatës. Por në fakt, Komisioni i kishte përfshirë në analizë, të ardhurat e përfituara sikurse janë pretenduar nga subjekti. Komisioni mori në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me pagat ndër vite dhe argumenton se ndryshimi i vetëm, tashmë i reflektuar edhe në analizën financiare, i takon vetëm të ardhurave për vitin 2005, ndërsa për vitet më pas, Komisioni thekson se ka marrë në konsideratë pagat e kaluara në llogarinë bankare të subjektit.

Subjekti kundërshtoi *marzhin* e fitimit të llogaritur nga Komisioni prej 80 %, duke e konsideruar atë si antiligjor, por nuk shpjegoi bindshëm apo të provonte me dokumentacion, se sa kanë qenë të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokate, por thjesht kundërshton pa asnjë provë llogaritjet dhe rezultatin e analizës financiare.

Komisioni në mbështetje të analizës financiare të kryer argumenton se nëse subjekti ka paguar tatim 8 % mbi qarkullimin referuar legjislacionit tatimor, edhe nëse fitimi nga ky aktivitet do të konsiderohej 100% dhe jo 80%, përsëri të ardhurat e përfituara nga subjekti do të përlllogariteshin në shumën 2.637.500 lekë dhe jo në shumën 6.800.000 lekë, sikurse janë deklaruar nga subjekti.

- **Trupi gjykues, çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat i avokatisë, dhe vendosi të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me këto të ardhura.**

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, Z. E. S.

5. Dyqan⁴⁴ me sip. 46 m², blerë në datën 21.4.1997.

Vlera e deklaruar: 30.000 USD.

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të E.S.

Burimi i krijimit: Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Mënyra e Fitimit: Kontratë shitblerje nr. ***, datë 21.7.1997, me palë shitëse A.K. dhe palë blerëse E.S., për blerje dyqani me sip. 46 m², në shumën 30.000 USD (dyqani kishte sip. 56 m², nga ku shitësi në vitin 1997 i ka shitur blerësit 46 m²).

Deklarimi para fillimit të detyrës, i burimit të krijimit: Blerje nga kursimet.

5.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

⁴⁴ Në lidhje me këtë pasuri subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues: vërtetim hipotekor nr. ***, datë 16.6.2006, për dyqan me sip. 56 m; aplikim për regjistrim në ZVRPP Shkodër, nga E.S. datë 06.06.2006; kontratë shitblerje, nr. ***, datë 21.7.1997;

ZVRPP-ja Shkodër⁴⁵, informon se në pronësi të z. E.S. rezulton pasuria nr. ***, vol. ***, f. *** dhe pasuria nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***. Të dyja këto pasuri janë ngjitur dhe në total kanë sipërfaqe 56 m².

Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi në deklaratën “Vetting”. Në përgjigjen e pyetësorit⁴⁶ subjekti ka argumentuar: “...kjo pronë është blerë me të ardhurat nga biznesi privat i subjektit dhe bashkëshortit”.

5.2 Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimin e ligjshëm

Nga të dhënat e disponuara Komisioni kreu verifikimin e të ardhurave të subjektit⁴⁷ dhe të bashkëshortit të saj për periudhën 1989 –1997.

5.3 Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga pagat

- Në vërtetimin nr. *** prot., datë 27.10.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, thuhet: “Në regjistrin e ministrisë figuron vetëm emërimi në detyrë në 26.8.1989 si Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Shkodrës”.
- Në vërtetimin nr. *** prot, datë 25.10.2016, të Ministrisë së Drejtësisë thuhet: “Ministria nuk disponon informacion për pagat gjatë periudhës 1989 – 1990 dhe 1990 –1992”.
- Në vërtetimin datë 17.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, thuhet: “...nuk disponohet informacion për të ardhurat e periudhës 1989 – 1990, pasi dokumentacioni është djegur në 1997–1998”.

Nga përgjigjet e pyetësorit⁴⁸, të ardhurat totale nga pagat për periudhën 1989 - 1992 të subjektit janë në shumën 33.300 lekë dhe një paraqitje e detajuar jepet në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 9

| Përshkrimi | 1989 | 1990 | 1991 | 1992 | Total |
|--|-------|-------|--------|-------|---------------|
| Të ardhura nga paga si Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Rrethit Shkodër | 2 600 | 6 500 | | | 9 100 |
| Te ardhura si avokate pranë Kolegjit të Avokatisë Shkodër | | 2 200 | 13 200 | 8 800 | 24 200 |
| Total | | | | | 33 300 |

5.4 Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti privat si avokate

Referuar ‘vërtetimit’ lëshuar nga DRT-ja Shkodër⁴⁹, znj. Valbona Durraj, ka regjistruar aktivitetin me vendim gjykate nr. ***, datë 25.8.1992, me kod fiskal ***. DRT-ja Shkodër nuk jep asnjë informacion në lidhje me fitimin neto nga aktiviteti, ndërkohë vërteton pagesat e detyrimeve tatimore për vitet 1992 – 1997.

DRT-ja Shkodër⁵⁰, nuk depozitoi informacionin e kërkuar nga Komisioni në lidhje me qarkullimin e deklaruar nga aktiviteti, por ridërgoi të njëjtin informacion në lidhje me pagesat e detyrimeve të tatimpaguesit Valbona Durraj dhe argumentoi bazën ligjore mbi të cilin është llogaritur dhe paguar detyrimi tatimor i subjektit që nga viti 1992.

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2019.

⁴⁶ Me shkresën, nr. *** prot., datë 12.4.2019.

⁴⁷ Subjekti, në deklaratën “Vetting” deklaroi të ardhura, si më poshtë:

nga paga si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër për periudhën 1989 – 1990 në shumën 9.100 lekë; nga paga si avokat pranë Kolegjit të Avokateve Shkodër për periudhën 1990 –1992 në shumën 24.200 lekë; nga aktiviteti si person fizik “Avokat” me licence, regjistruar në DRT-në Shkodër me vendim gjykate nr. ***, datë 24.10.1992, për periudhën 1992 –1997 në shumën 6.800.000 lekë; nga aktiviteti privat i bashkëshortit për periudhën 1991–1993 nuk provohen nga arkiva e institucionit; nga aktiviteti privat i bashkëshortit për periudhën 1994–1997 në shumën 4.700.000 lekë.

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.04.2019.

⁴⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 24.10.2016.

⁵⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2019.

Komisioni shqyrtoi legjislacionin përkatës⁵¹ tatimor për çdo vit dhe në bazë të të dhënave për tatimin e paguar nga aktiviteti si avokate përllorarit qarkullimin, si dhe fitimin faktik për periudhën 1992 – 1997, si më poshtë:

Tabela nr. 10

| Viti | Pagesat e tatimit në vite sipas vërtetimit të DRT Shkodër | Fitim neto i deklaruar nga subjekti në DPV | Marzhi i fitimit për këtë aktivitet | Pagesa në % mbi xhiron sipas ligjit. 7679, datë 3.3.1993 | Xhiro e përllorarit | Fitimi faktik i përllorarit |
|---------------|---|--|-------------------------------------|--|---------------------|-----------------------------|
| 1992 | 15 000 | 600 000 | 80% | 8% | 187 500 | 135 000 |
| 1993 | 36 000 | 1 200 000 | 80% | 8% | 450 000 | 324 000 |
| 1994 | 40 000 | 1 200 000 | 80% | 8% | 500 000 | 360 000 |
| 1995 | 40 000 | 1 300 000 | 80% | 8% | 500 000 | 360 000 |
| 1996 | 40 000 | 1 300 000 | 80% | 8% | 500 000 | 360 000 |
| 1997 | 40 000 | 1 200 000 | 80% | 8% | 500 000 | 360 000 |
| Totali | | 6 800 000 | | | | 1 899 000 |

5.5 Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti “tregti me pakicë të artikujve ushqimorë”

Referuar vërtetimit lëshuar nga DRT-ja Shkodër⁵², vërtetohet se z. E.S. ka pasur të regjistruar aktivitetin “tregti me pakicë e produkteve të tjera ushqimore (vezë, vaj, nënprodukte qumështi etj)”, me NIPT ***.

DRT-ja Shkodër, nuk jep asnjë informacion në lidhje me fitimin neto nga aktiviteti, ndërkohë vërteton pagesat e detyrimeve tatimore në vite, si dhe referon bazën ligjore në vite ku është bazuar përlloraritja dhe pagesa e tatimit.

Komisioni, në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga subjekti, si të përfituara nga aktiviteti i bashkëshortit në vitet 1996, 1997, për të cilët nuk provohet me anë të dokumentacionit ligjor se janë paguar detyrimet përkatëse, nuk mund t’i përfshijë në analizën financiare. Për vitin 1994 dhe 1995, Komisioni, bazuar në legjislacionin⁵³ në fuqi në atë kohë, përllorarit qarkullimin, si dhe fitimin neto, reflektuar në tabelën vijuese nr. 11.

Tabela nr. 11

| Viti | Pagesat e tatimit në vite sipas vërtetimit të DRT Shkodër | Fitim neto i deklaruar nga subjekti në DPV | Pagesa në % mbi xhiron sipas ligjit. 7679, dt. 3.3.1993 | Xhiro e përllorarit | Marzhi i fitimit ⁵⁴ | Fitim neto i përllorarit |
|------|---|--|---|---------------------|--------------------------------|--------------------------|
| 1994 | 17 550 | 1 000 000 | 5% | 351 000 | 15% | 35 100 |
| 1995 | 36 000 | 1 200 000 | 5% | 720 000 | 15% | 72 000 |
| 1996 | <i>mungon</i> | 1 300 000 | | | | |

⁵¹ Ligji nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, neni 1: “Personat fizike që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë.” Neni 2: “Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse dhe derdhet në buxhetin e shtetit.” Neni 3: “Llojet e veprimtarive që taten me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie janë: c) avokatët, mjekët dhe stomatologët, 8 %.”

⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2019.

⁵³ Ligji nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, Neni 1: “Personat fizike që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë”. Neni 2: “Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse dhe derdhet në buxhetin e shtetit.” Neni 3: “Llojet e veprimtarive që taten me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie janë: a) Tregtarët me pakicë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta, 5 %, por jo më pak se 12 mijë lekë në vit.”

⁵⁴ Marzhi i fitimit për aktivitetin është përllorarit si mesatare e fitimit të përllorarit nga vitet për të cilat ka të dhëna zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sa i përket qarkullimit dhe fitimit neto.

| | | | | | |
|---------------|---------------|------------------|--|--|-----------------------|
| 1997 | <i>mungon</i> | 1 200 000 | | | |
| Totali | | 4 700 000 | | | <u>107 100</u> |

Nga analiza e të dhënave të disponuara për periudhën 1989 –1997, të shpjeguara sa më sipër, në tabelën nr. 12, paraqitet analiza mbi mundësinë financiare të subjektit dhe të bashkëshortit të saj, për blerjen e dyqanit në shumën 30.000 USD (konvertuar⁵⁵ në 4.505.220 lekë).

Tabela nr. 12

| <u>Analiza financiare 1989 - 1997</u> | |
|--|--------------------|
| 1. Pasuri (dyqani në Shkodër blerë në vitin 1997) | 4 505 220 |
| Të ardhura subjekti nga paga | 33 300 |
| Të ardhura subjekti nga aktiviteti | 1 899 000 |
| Të ardhura bashkëshorti nga aktiviteti | 107 100 |
| 2. Total të ardhura | 2 039 400 |
| 3. Shpenzime jetese⁵⁶ | 1 008 000 |
| 4. Të ardhura - Shpenzime | 1 031 400 |
| 5. Rezultati (4-1) | - 3 473 820 |

Nga analiza financiare e kryer për periudhën 1989 – 1997, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare, në shumën - 3.473.820 lekë, për këtë fakt, subjektit, iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

5.6 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni duke argumentuar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë dyqanin me sip. 46 m² në vitin 1997. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat i ushtruar prej saj nga avokatia për periudhën 1989 – 1997, subjekti ka deklaruar se:

- për periudhën 1989 – 1992, të ardhurat janë 33.300 lekë;
- për periudhën 1992 – 1997, të ardhurat nga avokatia janë 6.800.000 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortit, subjekti ka argumentuar se aktiviteti i z. E.S. është një aktivitet i ligjshëm i regjistruar me vendim gjyqësor nr. ***, datë 21.3.1994, në DRT-në Shkodër.

Për periudhën 1994 – 1998, ligji i aplikueshëm ka qenë ligji nr.7679⁵⁷, datë 3.3.1993. Sipas këtij ligji, tatimi ka qenë 5 %, dhe se paguhej i ndarë me taksë fikse në katër këste, tre mujore përgjatë vitit kalendarik. Aktiviteti ka qenë i pa ndërprere, me të njëjtin kod fiskal, dhe fakti që për vitet 1996 -1998 mungon informacioni, nuk është përgjegjësi e subjektit. Mungesa e informacionit është përgjegjësi e vetë organit tatimor i cili sipas ligjit të kohës nr. 7546, datë 6.1.1992,⁵⁸ “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë”, në nenin

⁵⁵ Konvertuar me kursin e këmbimit të muajit kur është kryer ky transaksion 1 USD = 150.17 lekë

⁵⁶ Shpenzimet e jetesës janë llogaritur përafërsisht 2.800 lekë/muaj për person.

⁵⁷ Ligji rr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, Neni 1: “Personat fizike që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë”. Neni 2: “Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse dhe derdhet në buxhetin e shtetit.” Neni 3: “Llojet e veprimtarive që taten me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie janë: a) Tregtarët me pakicë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta, 5 %, por jo më pak se 12 mijë lekë në vit.”

⁵⁸ Ligji nr. 7546, datë 6.1.1992,⁵⁸ “Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë” neni 1. “Në Republikën e Shqipërisë administrimi i taksave dhe i tatimeve behet nga organet tatimore. organet tatimore janë drejtoria e tatimeve në M.F dhe organet e sajë në rrethe,

neni 2. Organet tatimore kryejnë të gjithë veprimet që lidhen me regjistrimin e subjektit, mbajnë dokumentacionin përkatës, nxjerrin akte tatimore dhe ruajnë dhe administrojnë dokumentacionin sipas dispozitave të veçanta.

2, thuhej: “Organet tatimore, mbajnë dokumentacionin përkatës, nxjerrin aktet tatimore, ruajnë dhe administrojnë dokumentacionin sipas dispozitave të veçanta.”

Subjekti shpjegon se nëse do të kishte ndërprerje të aktivitetit, nuk do të kishte të njëjtin kod fiskal, dhe nuk do të konfirmohej fakti që ky subjekt është tatim pagues i rregullt, kështu që, konkluzioni i Komisionit, që nuk mund t’i përfshijë në analizën financiare, është i padrejtë dhe bie në kundërshtim, jo vetëm me çfarë subjekti ka deklaruar më sipër, por dhe me qëndrimin e Gjykatës së Strasburgut, çështja “Driza kundër Shqipërisë”, Strasburg 13 nëntor, ku gjykata shprehet : “Individi nuk mban përgjegjësi për mos ruajtjen e dokumentacionin nga organet administrative”. Sipas subjektit përgjegjësia është e institucionit tatimor dhe jo e saj.

Për periudhën 1994 - 2007, subjekti ka pretenduar se DRT-ja Shkodër ka vërtetuar vetëm pagesat e detyrimit tatimor ndër vite, si dhe ka listuar bazën ligjore mbi të cilën janë përlllogaritur këto shuma të paguara. Në lidhje me fitimin neto të realizuar për periudhën 2004 – 2007, nuk jepet informacion.

Subjekti ka kundërshtuar *marzhin* e fitimit nga aktiviteti i bashkëshortit, të llogaritur nga Komisioni në vlerën 15 %, pasi pretendon se ky *marzh* fitimi i llogaritur nuk është i mbështetur në ligj. Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime⁵⁹, si për pasurinë 1, në lidhje me *marzhin* e fitimit të llogaritur nga Komisioni. Në këto kushte situata financiare, e llogaritur jo sipas ligjit, dhe jo nga një organ i përcaktuar me ligj, ka rënduar me keqdashje situatën financiare.

Subjekti ka kundërshtuar gjithashtu shpenzimet sipas ILDKPKI-së, me argumentet e cituar në pasurinë e parë⁶⁰. Subjekti ka kryer vetë analizën financiare dhe ka argumentuar se jo vetëm ka pasur mundësi paguese për blerjen e dyqanit në vitin 1997, por edhe ka pasur teprica.

Subjekti ka argumentuar se gjatë viteve për të cilat është kryer analiza financiare nga Komisioni nuk ka qenë në funksionin e gjyqtarës, pasi detyrën si gjyqtare e ka filluar në 1.6.1998, dhe dyqani është blerë në vitin 1997, ndërsa bashkëshorti i saj ka qenë në aktivitet privat të cilin e vazhdon edhe sot. Për pasojë, subjekti nuk mund të penalizohet për mosdokumentimin e të ardhurave për periudhën në të cilën nuk ka pasur asnjë funksion.

5.7 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Komisioni, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga subjekti nga aktiviteti privat i avokatisë, referon arsyetimin sipas pikës 4.2, sa më sipër.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga subjekti, që në periudhën kur ka blerë këtë pasuri nuk ka qenë në funksion, Komisioni, arsyen se në përputhje me Aneksin e Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe referuar praktikave të Kolegjit Posaçëm të Apelit, Komisioni, arrin në përfundimin se pasuritë e subjektit të rivlerësimit të deklaruara në deklaratën “Vetting”, i nënshtrohen kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, mbi saktësinë e deklaramit dhe mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë kufizim, i artikuluar ky, sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kriteret kufizuese vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe të personave të lidhur, me qëllim përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit

neni 3. Akti tatimore nxirret në baze të deklaratës dhe të dhënave të tjera të pasqyruara nga subjekti sipas afateve dhe kërkesave të caktuara me dispozita ligjore. Organi tatimore përcakton bazën dhe madhësinë e tatimit në aktet tatimore”.

⁵⁹ Për më shumë shih pikës 1.3.

⁶⁰ Për më shumë shih pikës 1.3.

të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni arrin në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme, apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimit të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit dhe rolit të tij në dhënien e drejtësisë.

Komisioni, krijoi bindjen se ligji kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Durraj, qofshin këto pasuri të krijuara para apo pas emërimit në detyrë si gjyqtare. Hetimi i të gjitha pasurive të subjektit të rivlerësimit të deklaruar ose jo bëhet për të përjashtuar çdo mundësi që këto pasuri të jenë krijuar me anë të akteve korruptive gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, apo abuzimit të çdo forme të saj me detyrën, apo nga veprimtari të tjera të kundërligjshme, që cenojnë figurën dhe integritetin e gjyqtarit dhe e bëjnë atë të pabesueshëm në sytë e publikut, për sa kohë që sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjetjet janë për pasuritë e krijuara para periudhës së fillimit të detyrës si gjyqtare, Komisioni, përveç faktit të përmendur se këto pasuri janë deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, thekson se subjekti i rivlerësimit nga viti 2003 ka qenë subjekt deklarues për pasurinë në ILDKPKI dhe për rrjedhojë pasuritë e vëna gjatë kësaj periudhë janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi.

- **Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, çmon se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

6. Pjesë e pandarë e dyqanit me sipërfaqe 10 m².

Vlera e deklaruar: 500.000 lekë.

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të z. E.S.

Burim krijimi: Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Mënyra e fitimit: Kontratë shitblerje nr. ***, datë 11.1.2006, me palë shitëse A.K. dhe me palë blerëse E.S. për blerjen e sip. 10 m² me vlerë 500.000 lekë.

Deklarimi sipas DPV: Blerje e sip. 10 m² (magazinë) sipas kontratës së shitblerje nr. ***, datë 11.1.2006.

6.1 Faktet e konstatuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Shkodër⁶¹, ka konfirmuar njësinë, me sip. 56 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të E.S.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2018.

ZVRPP-ja Shkodër ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.1.2006, të nënshkruar ndërmjet A.K. si palë blerëse dhe E.S. në cilësinë e shitësit, për blerjen e një pasurie me sip. 10 m², në çmimin 500.000 lekë. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së rezultojnë një vërtetim i datës 16.6.2006, për pasurinë me sip. 56 m² me nr. pasuri ***, në z.k. ***, ku janë bashkuar të dy pasuritë: dyqan dhe shtesa me sip. 10 m², e cila blihet më vonë nga subjekti.

Në përgjigjen e pyetësorit⁶² subjekti ka argumentuar: “Kjo pronë është blerë me të ardhurat nga biznesi privat i subjektit dhe i bashkëshortit”.

6.2 Komisioni kreu analizën financiare për analizuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

Subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 ka deklaruar:

- të ardhura nga paga si gjyqtare në vlerën 771.500 lekë, dhe pagën si kryetare gjykate në vlerën *neto* prej 243.600 lekësh;
- të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, z. E.S., në vlerën *neto* 1.300.000 lekë;
- të ardhura në shumën prej 3.600 euro nga qiraja e apartamentit në Tiranë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, në lidhje me të ardhurat, u konstatua se:

- për vitin 2006 shuma totale e të ardhurave nga paga, kaluar në llogarinë bankare rezultojnë të jetë 1.006.497 lekë;
- për sa i përket informacionit mbi të ardhurat nga aktiviteti privat i z. E.S. për vitin 2006, referuar vërtetimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër⁶³, fitimi *neto* i përlllogarit në bazë të detyrimit total të paguar sipas legjislacionit përkatës në vitin 2006 dhe *marzhi*⁶⁴ të fitimit për sektorin është në shumën rreth 645.000 lekë;
- të ardhurat nga qiraja janë konvertuar në lekë me kursin fiks të euros, për vitin 2006 dhe rezultojnë në shumën 45.331 lekë.

Në lidhje me Detyrimet, subjekti gjatë vitit 2006, ka shlyer detyrimin në shumën 9.000 euro, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Analiza financiare për vitin 2006:

Të dhënat e analizuara për këtë vit lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 13

| | Viti | <u>2006</u> |
|----------|--|--------------------|
| | Pasuri | 335 118 |
| | Magazina 10 m ² blerë në vitin 2006 | 500 000 |
| | Ndryshim i likuiditetit | - 164 882 |
| | Detyrime | - 1 113 327 |
| | Detyrim firmës së ndërtimit për Apt në Tirane 130 m ² | -1 113 327 |
| 1 | Pasuri neto (Pasuri - Detyrime) | 1 448 445 |
| 2 | Të ardhura | 2 096 828 |

⁶² Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2019.

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 21.11.2018.

⁶⁴ *Marzhi* i fitimit për aktivitetin është përlllogarit si mesatare e fitimit të përlllogarit nga vitet për të cilat ka të dhëna zyrtare për aktivitetin e E.S. nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për sa i përket qarkullimit dhe fitimit *neto*.

| | | |
|----------|---|------------------|
| | Të ardhura nga paga subjekti | 1 006 497 |
| | Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat) | 645 000 |
| | Të ardhura nga qiraja e apartamentit | 445 331 |
| 3 | Shpenzime | 893 455 |
| | Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 438 228 |
| | Shpenzime <i>TIMS</i> | 455 227 |
| | Rezultati (2-3-1) | - 245 072 |

Nga analiza e të dhënave, rezultoi se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet, për të shlyer detyrimin ndaj firmës së ndërtimit dhe për të blerë pjesën e pandarë të dyqanit, në shumën **- 245.072 lekë**.

6.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.3.1 Subjekti kundërshtoi analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke kërkuar:

- pasqyrimin e të dhënave reale të të ardhurave të saj;
- rregullimin e shpenzimeve sipas *TIMS*; si dhe
- shpenzimet e jetesës sipas prapësimeve të subjektit (trajtuar në pikën 1.3).

6.4 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave

Komisioni reflektoi në analizën financiare për vitin 2006 pretendimet e subjektit lidhur me shpenzimet e llogaritura për udhëtimet jashtë vendit për arsye pune.

Tabela nr. 14

| | | Viti 2006 |
|----------|--|--------------------|
| | Pasuri | 335 118 |
| | Apartamenti në Tiranë | |
| | Autoveturë | |
| | Magazina me sip. 10 m ² blerë në vitin 2006 | 500 000 |
| | Ndryshim i likuiditetit | - 164 882 |
| | Detyrime | - 1 113 327 |
| | Detyrim firmës së ndërtimit për apartament me sip. 130 m ² , Tiranë | - 1 113 327 |
| 1 | Pasuri neto (Pasuri - Detyrime) | 1 448 445 |
| 2 | Të ardhura | 2 096 828 |
| | Të ardhura nga paga subjekti | 1 006 497 |
| | Të ardhura bashkëshorti (aktiviteti privat) | 645 000 |
| | Të ardhura nga qiraja e apartamentit | 445 331 |
| 3 | Shpenzime | 805 626 |
| | Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së | 438 228 |
| | Shpenzime <i>TIMS</i> | 367 398 |
| | Rezultati (2-3-1) | - 157 243 |

Përfundimisht, u konstatua se Subjekti i rivlerësimit, për vitin 2006 ka një balancë financiare negative në shumën **- 157.243 lekë**.

7. Të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 1992 – 2016

- Biznes privat me vendim gjykatë nr. ***, datë 21.9.1991, i regjistruar në Komitetin Ekzekutiv, sektori financës me nr. regjistri ***, datë 20.9.1991, import-eksport; vërtetim

negativ, nr. *** prot., datë 21.10.2016; s'ka dokumentacion nga arkiva e ish-Komitetit Ekzekutiv për periudhën 1991 – 1993.

- Person fizik “***”, me vendim gjykate nr. ***, datë 21.3.1994, me NIPT ***; vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga DRT-ja Shkodër; vërtetim i Bashkisë Shkodër nr. *** prot., datë 18.10.2016.
- Fitim nga biznesi për periudhën 21.3.1994 – 31.12.2015.
- Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Benz”, me targa ***, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 5.8.2015, në vlerën 7.000 euro.
- Nr. llogarie individ në “BKT” dhe nr. llogarie person fizik, në “BKT”, të lëvizshme likuidim biznesi.
- Të gjitha detyrimet nga biznesi nga momenti i krijimit e deri në datën 18.1.2017, të likuiduara (vërtetim nga DRT-ja, nr. *** prot., datë 18.1.2017, dhe nr. *** prot., datë 21.10.2016).

7.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të ardhura nga aktiviteti si person fizik, në vlerën totale rreth 25.600.000 lekë, për periudhën 1994 – 2015.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, si dhe konfirmimit të ardhur nga DRT-ja Shkodër, rezulton se të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti nuk përputhen me të ardhurat e dokumentuara nga DRT-ja Shkodër⁶⁵.

- Në tabelën vijuese paraqiten të ardhurat e deklaruara dhe ato të dokumentuara.

Tabela nr. 15

| E.S. | | | | |
|------------------------|-----------|---------------------------------------|----------------------------|----------------------|
| Funksioni | Viti | Të ardhura të deklaruara në “Vetting” | Të ardhura të dokumentuara | Komente |
| Biznes privat | 1991-1993 | | 0 | Nuk ka dokumentacion |
| Person fizik 21.3.1994 | 1994 | 1,000,000 | 35,100 | - |
| | 1995 | 1,200,000 | 72,000 | - |
| | 1996 | 1,300,000 | 0 | Nuk ka dokumentacion |
| | 1997 | 1,200,000 | 0 | Nuk ka dokumentacion |
| | 1998 | 1,300,000 | 0 | Nuk ka dokumentacion |
| | 1999 | 1,300,000 | 260,000 | - |
| | 2000 | 1,300,000 | 260,000 | - |
| | 2001 | 1,300,000 | 99,000 | - |
| | 2002 | 1,200,000 | 148,500 | - |
| | 2003 | 1,200,000 | 268,400 | - |
| | 2004 | 1,200,000 | 296,340 | - |
| | 2005 | 1,200,000 | 264,825 | - |
| | 2006 | 1,300,000 | 179,768 | - |
| | 2007 | 1,200,000 | 451,000 | - |

⁶⁵ Në deklaratën periodike, vjetore për vitin 2003, subjekti ka deklaruar fitim 3.552.000 lekë ndërsa në deklaratën “Vetting” ka deklaruar 1.200.000 lekë.

| | | | | |
|-------------------------|------|-------------------|------------------|---|
| | 2008 | 1,000,000 | 765,000 | - |
| | 2009 | 1,200,000 | 747,000 | - |
| | 2010 | 1,000,000 | 540,516 | - |
| | 2011 | 1,000,000 | 438,374 | - |
| | 2012 | 750,000 | 489,516 | - |
| | 2013 | 950,000 | 493,457 | - |
| | 2014 | 1,000,000 | 395,481 | - |
| | 2015 | 1,500,000 | 369,908 | - |
| | 2016 | 0 | 729,418 | - |
| Total të ardhura | | 25,600,000 | 7,303,603 | |

Nga analiza e kryer nga Komisioni, rezultoi se

- ✓ **ka mospërputhje deklarimesh**, pasi të ardhurat e bashkëshortit nga biznesi, për periudhën 2003 – 2016, janë deklaruar në shumën 25.600.000 lekë dhe të ardhurat sipas dokumentacionit të administruar në dosje janë në shumën 7.303.603 lekë, fakt për të cilin subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

7.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, janë parashtruar në pikën 1.3, të këtij vendimi.

7.3 Arsytimi ligjor dhe analiza e provave

Komisioni ka parashtruar argumentet për këtë çështje në pikën 1.4 të këtij vendimi.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se prapësimet e subjektit, për të ardhurat nga aktiviteti privat i subjektin dhe i bashkëshortit të saj, nuk u mbështetën në prova bindëse për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni.

- ✓ **Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues, çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm për këto të ardhura.**

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kriterëve në vlerësimin e përgjithshëm, në kriterin e pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti e rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrëj),

- i. ka deklarim të pasaktë të pasurive dhe të interesave private, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D, të aneksit të Kushtetutës;
- ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve;
- iii. ka fiktivitet në lidhje me dy kontratat noteriale për shitjen e një pasurie, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore (evazion fiskal), për shkak të dorëzimit në ZVRPP të kontratës me vlerë më të ulët se vlera e shitjes së pasurisë;

- iv. ka deklarin të rremë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i avokatisë dhe nga aktiviteti privat i bashkëshortit;
- v. ka ndërtimin të paligjshëm në vitin 2013 të godinës 2-katëshe, në Velipojë, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar ndërtimin dhe mobilimin e kësaj godine;
- vi. ka deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Seknaj (Durrëj), me funksion gjyqtare/kryetare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Olsi KOMICI

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha

P/ Olsida Goxhaj